



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 640/prot.  
38

Tiranë, më 30. 01/2026

**RAPORT**

PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT:  
**"MBI ÇËSHTJET E PROCEDUARA PËR HERË TË PARË ME KËRKESË OSE  
VENDIMMARRJE TË PROKURORIT PËR PUSHIM PËR SHKAK TË  
PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE, PËR PERIUDHËN 01.01.2024-  
31.12.2024"**

I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në zbatim të vendimit nr. 10, datë 08.03.2025 "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt:  
*Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për  
pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024"*  
i ndryshuar me vendimin nr. 10/1, datë 30.10.2025 dhe nr. 84, datë 30.12.2025 të Inspektorit  
të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, Janar 2026

1

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

### Titulli:

Raporti i inspektimit tematik "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024"

### Data e përgatitjes:

30.01.2026

### Përgatitur nga:

Juliana Zonja, Lindita Ziguri

### Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Artur Metani



Miratoi  Ndryshoi  Ktheu

Date 30.01. 2026

## 1. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrove të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025, planin e inspektimeve për vitin 2025.

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 "Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025", është zhvilluar inspektimi tematik me objekt: "Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024".

Inspektimi tematik, sipas vendimit nr. 10, datë 08.03.2025, i ndryshuar me vendimin nr. 10/1, datë 30.10.2025 dhe nr. 84, datë 30.12.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u zhvillua pranë:

- a- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
- b- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Për kryerjen e inspektimit, u ngarkuan inspektorët:

- a- Z. Julian Zonja për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
- c- Znj. Lindita Ziguri për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 147/d, pika 2, e cila parashikon se: "2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrove të prokurorisë", në ligjin

nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenin 204, pika 1, gërma "dh", e cila parashikon se: "Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme dh): "... miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale e tematike", si dhe në vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2025".

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorive lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- Vendimi Unifikues nr. 7, datë 11.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Me vendimin nr. 10, datë 08.03.2025 i ndryshuar me vendimin nr. 10/1, datë 30.10.2025 dhe nr.84, datë 30.12.2025 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur ndër të tjera: Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: "Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024", sipas të cilit; Hartimi i Raportit përfundimtar do të bëhet brenda datës 31.1.2026.

Referuar Vendimeve, inspektimi tematik u realizua dhe përfundoi sipas këtyre fazave:

- a- përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akteve, brenda datës 03.03.2025;
- b- përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur, brenda datës 30.10.2025;
- c- hartimi i raportit përfundimtar, brenda datës 31.1.2026;
- d- ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit.

Inspektimi tematik u krye nëpërmjet administrimit pranë prokurorive të lartpërmendura, të të dhënave, informacionit, apo dokumentacionit shkresor në lidhje me:

- a- Informacion mbi numrin e çështjeve penale të regjistruara, shqyrtuara dhe konstatuara nga gjykata për pushim të proceduara për herë të parë, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale, në bazë të kërkesës së prokurorit ose ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale për këtë shkak ose çfarëdo shkakuj tjetër, në periudhën 01.01.2024-31.12.2024.
- b- Vendimet gjyqësore, kërkesat e prokurorit për pushim dhe vendimet e prokurorit për

- pushim të çështjes penale, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale gjatë vitit 2024.
- c- Vendimet gjyqësore, nëse ka patur raste në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak i kërkesës së prokurorit ose vendimit të pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024.
  - d- Informacion dhe dokumentacion për rastet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatës që ka vendosur pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, kur shkak i pretenduar ka qenë për parashkrim të ndjekjes penale.
  - e- Çdo e dhënë apo akt tjetër që çmohet se mund të jetë i rëndësishëm për kryerjen e këtij inspektimi tematik, në përputhje me parashikimet e nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

Për kryerjen e këtij inspektimi, u ngarkuan inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:

- a- Inspektori Julian Zonja, asistuar nga Ndhmësinsektor z. Renato Tushaj për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat,
- b- Inspektori Lindita Ziguri, asistuar nga Ndhmësinsektore znj. Loreta Jashari për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Me synim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe mirëadministrimit të procesit, u caktua si Kryetar grupi z. Julian Zonja, përgjegjës për bashkërendimin e punës për hartimin e planit dhe hartimin e afateve konkrete, vendosjen e kontakteve me drejtuesit e prokurorive, kërkimin e informacionit, ndjekjen e ecurisë së punës, administrimin e korrespondencës në një databazë për aksesim nga i gjithë grupi i inspektimit, unifikimin e praktikës së punës për strukturën e projekt-raportit të inspektimit, koordinimin e punës për hartimin e raportit përfundimtar, informimin periodik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe paraqitjen e draft-raportit përfundimtar të inspektimit me gjetjet përkatëse për miratim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i grupit, në bashkëpunim me inspektorin tjetër përgjegjës, hartoi dhe dorëzoi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin për vijimin e punës, brenda datës 03.03.2025.

Kryetari i grupit të inspektimit ka raportuar në përfundim të çdo faze inspektimi të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në çdo rast që kërkohej prej tij.

Projektvendimi dhe raporti i inspektimit u hartua nga inspektorët dhe i dërgohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shqyrtim, brenda datës 31.1.2026, sipas përcaktimeve në nenin 214,

pika 6 të ligjit nr. 115/ 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Qëllimi i këtij inspektimi tematik ishte identifikimi i çështjeve penale të shqyrtuara dhe konstatuara nga gjykata për pushim, të proceduara për herë të parë, në bazë të kërkesës së prokurorit ose ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale me shkak parashkrimin e ndjekjes penale, në periudhën 01.01.2024-31.12.2024, duke identifikuar: Vendimet gjyqësore, kërkesat e prokurorit për pushim dhe vendimet e prokurorit për pushim të çështjes penale me shkak parashkrimin e ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Vendimet gjyqësore, nëse ka patur raste në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak i kërkesës së prokurorit ose i vendimit të pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Rastet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatës që ka vendosur pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, kur shkak i pretenduar ka qenë për parashkrim të ndjekjes penale.

Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar qartë detyrimet e magjistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale. Kështu, në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Në këtë inspektim u shqyrtua fillimisht dokumentacioni i rasteve (procedimeve penale) të pushuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, me kërkesë të prokurorit për pushim ose vendim pushimi. Në vazhdim, me analizimin e praktikave, u evidentuan rastet e parashkrimit të ndjekjes penale për shkak të ekzistencës së një vendimi pezullimi, si dhe rastet e parashkrimit të ndjekjes penale në hetim, duke verifikuar dokumentacionin e rasteve të fundit për të konkluduar lidhur me shkaqet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, mundësoi vënien në dijeni mbi çështjet e proceduara me kërkesë ose vendim të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, gjatë vitit 2024, duke evidentuar edhe shkaqet e parashkrimit, për të nxjerrë edhe përfundimet lidhur me ushtrimin e funksionit të prokurorit në përputhje me ligjin.



Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024 rezultoi se:

### **1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 640/3 prot., datë 05.03.2025, kërkoi informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, mbi numrin e çështjeve penale për të cilat prokurori ka bërë kërkesë për pushim ose vendim pushimi nga data 01.01.2024 - 31.12.2024, duke specifikuar datën e regjistrimit dhe datën e pushimit për çdo çështje penale.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 3569/1 prot., datë 15.05.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/8 prot., datë 15.05.2025, është dërguar informacioni, se në këtë prokurori për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, për shkak parashkrimi të ndjekjes penale **janë pushuar gjithsej 349 procedime penale** me kërkesë për pushim ose vendim pushimi dhe ndër këto vetëm procedimi nr. 879 viti 2017 i regjistruar për nenin 89 të K. Penal është pushuar me vendim nga prokurori i çështjes. Bashkëlidhur është dërguar lista e printuar, ku paraqitet numri i procedimit, data e regjistrimit, neni për të cilin është regjistruar, data e pezullimit të hetimeve për procedimin dhe data e vendimmarrjes së prokurorit për pushimin e çështjes.

Rezulton që për të gjitha rastet e përcjella (349 procedime penale) të jenë pezulluar hetimet dhe rifilluar me qëllim pushimin e tyre, pasi janë plotësuar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Me shkresën nr. 640/12 prot., datë 28.07.2025 të ILD-së, në vijim të korrespondencës, për shkak se të dhënat nuk ishin dërguar në përputhje me kërkesën, është rikërkuar informacion lidhur me procedimet penale për të cilat është kërkuar ose vendosur pushimi i çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale në hetim.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 11091/1 prot., datë 17.09.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/20 prot., datë 18.09.2025, është dërguar informacioni se për periudhën nga data 01.01.2024 - 31.12.2024, nuk rezulton të ketë procedime penale që të jenë parashkruar në hetim dhe që për këtë shkak prokurorët të kenë marrë "Vendim për pushimin e hetimeve", apo t'i jenë drejtuar gjykatës me "Kërkesë për pushimin e hetimeve".



Me shkresën nr. 640/18 prot., datë 16.09.2025 të ILD-së, në vijim të korrespondencës, si dhe referuar informacionit dhe materialit të përcjellë, është kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kopje e njëzuar me origjinalin e fletëve të regjistrimit të njoftimit të veprave penale, ku të jenë evidentuar të gjitha procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2019 (numër dhe datë procedimi, vepra penale, etj).

Në kuadër të inspektimit tematik, inspektorët shkuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku në datën 13.11.2025, mbajtën procesverbal "Për kqyrjen e regjistrimit të procedimeve penale në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë", ku rezultoi:

Procedimet penale të regjistruara nga kjo zyrë prokurorie rezultojnë të pasqyruara në 3 (tre) volume, ku për vitin 2019, në total janë regjistruar 1071 procedime penale. Në lidhje me këto procedime u konstatua që për një pjesë të tyre mungojnë shënimet në regjistër, kryesisht në lidhje me mënyrën dhe datën e përfundimit të çështjes dhe konkretisht për 102 procedime. Ndërsa, me shkresën nr. 16751 prot., datë 13.11.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka dërguar nëpërmjet një CD, kopje të regjistrimit elektronik të procedimeve penale të vitit 2019.

Verifikimi në vend u krye, duke ndërthurur të dhënat e regjistrimit fizik me regjistrin elektronik dhe u arrit në konkluzionet sipas procesverbalit të mbajtur në datën 13.11.2025.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 640/5 prot., datë 05.03.2025 është kërkuar informacion dhe dokumentacion, mbi numrin e çështjeve penale të regjistruara, shqyrtuara dhe konstatuara nga gjykata për pushim, të proceduara për herë të parë, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale, në periudhën 01.01.2024-31.12.2024; Vendimet gjyqësore, kërkesat e prokurorit për pushim dhe vendimet e prokurorit për pushim të çështjes penale, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Vendimet gjyqësore, nëse ka patur raste në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak i kërkesës së prokurorit ose i vendimit të pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Informacion dhe dokumentacion për rastet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatës që ka vendosur pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, kur shkak i pretenduar ka qenë për parashkrim të ndjekjes penale.

Kjo shkresë është përsëritur për shkak të mosdërgimit të informacionit të kërkuar dhe është dërguar sërish nga ILD me shkresën nr. 640/11 prot., datë 28.07.2025.

Në përgjigje të shkresave të ILD, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 843/1 prot., datë 08.05.2025 regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/13 prot., datë 06.08.2025, është dërguar informacioni dhe dokumentacioni:

- Në lidhje me kërkesat e prokurorit për pushim dhe vendimet e prokurorit për pushim të çështjes penale, nga dosjet gjyqësore me shkak parashkrimin e ndjekjes penale gjatë vitit 2024, **janë dërguar 395 vendime gjyqësore penale**, të cilave u është bashkëlidhur kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale; 5 (pesë) vendime, me formë të prerë, në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak u pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024; 12 (dymbëdhjetë) vendime të administruara pranë zyrës së kryesekretarisë, ku është vendosur kthimi i akteve, të cilat janë ankimuar dhe ndodhen në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit, bashkëlidhur shkresa përcjellëse; 22 (njëzet e dy) vendime për pushimin e hetimeve, ndaj të cilave është ushtruar ankim, bashkëlidhur shkresa përcjellëse mbi dërgimin e dosjes penale pranë Gjykatës së Apelit.

Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 640/24 prot., datë 20.10.2025 në vijim të korrespondencës, i është kërkuar gjykatës, kopje e dosjes së prokurorisë dhe dosjes gjyqësore lidhur me tre vendime të dërguara nga kjo gjykatë, për të cilët është vendosur pushimi i hetimeve për tre procedime penale, për të cilat nuk rezultoi të ishte marrë më parë vendim për pezullimin e hetimeve.

Me shkresën nr. 1169/1 prot., datë 24.10.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/24 prot., datë 29.10.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka dërguar dosjet vetëm për dy vendime:

- Vendimi nr. 2716-1079, datë 19.09.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; objekt të kërkesës: *Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 368 viti 2018, i regjistruar për veprën penale të "Mospagimi i taksave dhe i tatimeve", e parashikuar nga neni 181 i K. Penal.*
- Vendimi nr. 53-2024-3409 (1113), datë 07.11.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; objekt të kërkesës: *Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 47 viti 2020, i regjistruar për veprën penale "Braktisja e fëmijëve të mitur", parashikuar nga neni 124/1 të K. Penal.*

Ndërsa për dosjen e vendimit të tretë, Vendimi nr. 2015-313, datë 27.06.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me kërkesë Prokuroria pranë



Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; objekt të kërkesës: *Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1007 viti 2019, i regjistruar për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", e parashikuar në nenin 186/2 të K. Penal, jemi bërë me dije se dosja gjyqësore ndodhej në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.*

Me shkresën nr. 640/30 prot., datë 04.11.2025, ILD i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë për dosjen e vendimit nr. 2015-313, datë 27.06.2024. Me shkresën nr. 24152/1 prot., datë 13.04.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/33 prot., datë 14.11.2025, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka dërguar kopje të njësuar të dosjes lidhur me vendimin nr. 2015-313, datë 27.06.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

***Lidhur me dosjet hetimore të vendimeve të sipërcituar rezulton:***

1) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka regjistruar procedimin penal nr. 368, datë 23.10.2018 për veprën penale të **"Mospagimi i taksave dhe tatimeve"**, parashikuar nga neni 181 i K. Penal, **pa autor.**

Me kërkesën e datës 10.05.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, pushimin e çështjes penale për procedimin penal nr. 368, viti 2018 për veprën penale "Mospagimi i taksave dhe tatimeve", parashikuar nga neni 181 i K. Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi për këtë vepër penale ka kaluar afati i parashkrimit prej 5 vitesh, i parashikuar në nenin 66/ç të K.Penal, kjo vepër është parashkruar në vitin 2023.

Me vendimin nr. 2716-1079, datë 19.09.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka pranuar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. 368 të vitit 2018, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për veprën penale "Mospagimi i taksave dhe tatimeve", parashikuar nga neni 181 i K Penal me arsyetimin se fakti penal ka ndodhur për periudhat tatimore të disa viteve të ndryshme 2015, 2016 e 2017. Duke qenë se kemi të bëjmë me një krim vazhdues dhe duke qenë se veprimi i fundit i kundërligjshëm ka ndodhur në vitin 2017, vepra penale e fundit është parashkruar deri në fund të vitit 2023.

Referuar dosjes penale ka rezultuar se hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët: Bardhyl Shehu, nga data 23.10.2018 e regjistrimit të procedimit penal deri në

datën 10.08.2023<sup>1</sup>; Irena Sufaj<sup>2</sup> nga data 10.8.2023 e në vijim, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit deri në fund të vitit 2023, e cila ka kërkuar pushimin çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale pas 5 muaj e 10 ditë nga dita e plotësimit të afatit të parashkrimit.

2) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin në datën 30.01.2020, ka regjistruar procedimin penal me nr. 47, të vitit 2020 për veprën penale **“Braktisja e fëmijëve të mitur”**, parashikuar nga neni 124 i K. Penal, **pa autor**.

Me kërkesën pa datë, regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në datë 19.06.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, pushimin e hetimeve në procedimin penal nr. 47/2020, për veprën penale “Braktisja e fëmijëve të mitur”, parashikuar nga neni 124/1 i K. Penal, me arsyetimin se vepra penale është kryer më datë 27.05.2017. Nga momenti i kryerjes së veprës kanë kaluar më shumë se pesë vjet të parashikuara nga neni 66 i K. Penal për kategorinë e veprave që parashikojnë dënim gjer në 5 vjet burgim, ku bën pjesë edhe vepra penale e parashikuar nga neni 124/1 i K. Penal.

Me vendimin nr. 1113, datë 07.11.2024 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për pushimin e çështjes penale nr. 47 të vitit 2020, për veprën penale “Braktisja e fëmijëve të mitur”, të parashikuar nga neni 124/1 i K. Penal me arsyetimin se duke marrë për bazë datën 27.05.2017 kur ka ndodhur fakti penal, në rastin konkret është parashikuar ndjekja penale që më datë 28.05.2022.

Referuar dosjes penale ka rezultuar se hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Bardhyl Shehu, nga data 30.01.2020 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësimin e prokurorit), periudhë gjatë të cilës është plotësuar edhe afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale në datën 28.5.2022, pasi për afatin e mbetur prej 2 vjet 3 muaj e 28 ditë në periudhën që e ka pasur në hetim ky prokuror nuk është marrë asnjë person si i pandehur; Iva Harka nga data 12.10.2023 deri në datën 4.4.2024 (vendim zëvendësimi); Sabri

<sup>1</sup> Prokurori z. Bardhyl Shehu është shkarkuar me vendim të KPK-së nr. 694, datë 10.08.2023 dhe përfundimisht me vendim të KPA-së datë 19.11.2025 (lënë në fuqi vendimi i KPK-së).

<sup>2</sup> znj. Irena Sufaj është emëruar magjistrat me vendimin nr. 221, datë 27.06.2023 të KLP-së dhe është caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me vendimin nr. 267, datë 10.07.2023.

Kastrati nga data 4.4.2023 deri në datën 19.6.2024, i cili ka marrë dosjen të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak pas 2 vjet e 21 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 30.1.2020 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin korrik 2021 (*urdhër delegimi i veprimeve hetimore i prokurorit Bardhyl Shehu, procesverbal i kqyrjes së sistemit TIMS datë 01.06.2020, relacion i OPGJ datë 01.06.2021 për pezullimin e procedimit penal, shkresë nr. 3117 prot., datë 26.07.2021 e Komisarariatit të Policisë Kurbën për dërgimin e procedimit penal nr. 47, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbën*).

3) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar **pa autor**, procedimin penal nr. 1007, datë 18.11.2019 për veprën penale "**Falsifikimi i dokumenteve**" parashikuar nga neni 186/2 i K. Penal, (*prokurori ka kërkuar pushimin e procedimit, në lidhje me të cilën gjykata me vendimin nr. 269, datë 29.05.2022, ka vendosur kthimin e akteve për kryerjen e hetimeve shtesë*). Prokurori i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit, e cila është pranuar nga gjykata me vendimin nr.2015- 313, datë 27.6.2024. Ndaj këtij vendimi kallëzuesja ka ushtruar ankim në datën 22.11.2024 dhe çështja është ende në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ka konkluduar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/2 i K. Penal, por që ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe hetimet duhen pushuar sepse ndjekja penale është parashkruar në kuptim të nenit 66/ç të K. Penal, duke referuar në arsyetim periudhën 2005- 2011 të kryerjes së veprës penale.

Nga të dhënat e administruara në lidhje me këtë procedim, nisur nga data e kryerjes së veprimeve të falsifikimit rezulton që vepra penale e parashikuar nga neni 186/2 i K. Penal, të ishte parashkruar para vitit 2019 të regjistrimit të procedimit penal dhe në këto kushte konstatimet lidhur me këtë procedim, janë jashtë objektit të inspektimit.

## 2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 640/4 prot., datë 05.03.2025, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, mbi numrin e çështjeve penale për të cilat prokurori ka bërë kërkesë për pushim ose vendim pushimi nga data 01.01.2024 - 31.12.2024.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me shkresën nr. 685/1 prot., datë 25.03.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/7 prot., datë



27.03.2025, është dërguar tabela e plotësuar me të dhënat e kërkuara ku rezulton të jetë përcjellë informacion për 191 procedime penale.

Me shkresën nr. 640/10 prot., datë 23.07.2025, në vijim të korrespondencës dhe materialit të dërguar është kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, specifikimi i procedimeve penale që kanë të bëjnë me dosjet pezulluara dhe të rifilluara për pushim për shkak parashkrimi dhe i procedimeve penale me kërkesë/vendim pushimi për herë të parë që janë parashkruar gjatë hetimit (jo të rifilluara).

Me shkresën nr. 2231/1 prot., datë 09.09.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/15 prot., datë 11.09.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka dërguar të dhëna për dosjet penale të pezulluara dhe më pas të rifilluara për shkak parashkrimi, si dhe ato procedime penale me kërkesë/vendim pushimi për herë të parë që janë parashkruar gjatë hetimit, ku sipas tabelës së përcjellë, figurojnë 187 procedime, nga të cilat 23 janë parashkruar gjatë hetimit.

Me shkresën nr. 640/17 prot., datë 16.09.2025, ILD i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ku në vijim të korrespondencës i është kërkuar kopje e fletëve të regjistrimit të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019.

Me shkresën nr. 640/19 prot., datë 17.09.2025, ILD i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat kopje të vendimeve të pushimit të prokurorit (për kundërvajtjet), nëse ka ankim bashkëlidhur dhe vendimi përkatës i gjykatës; kërkesat për pushim dhe vendimet gjyqësore që u përkasin procedimeve penale të pezulluara dhe më pas të rifilluara për efekt parashkrimi të ndjekjes penale për vitin 2024.

Me shkresën nr. 2810/2 prot., datë 30.10.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/29 prot., datë 03.11.2025, në përgjigje të shkresës nr. 640/19 prot., datë 17.09.2025, Prokuroria ka dërguar kopje të dy kërkesave për pushim, të procedimit penal nr. 82 viti 2014 dhe procedimit penal nr. 529 viti 2018.

Në vijim të korrespondencës dhe dokumentacionit të dërguar, Prokuroria Berat me shkresën nr. 34/1 prot., datë 12.1.2026, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/37 prot., datë 14.01.2026 ka dërguar vendimet gjyqësore të pushimit për 80 procedime penale, nga të cilat 18 për kundërvajtje penale, ndërsa për 4 procedime penale 2 (nr. 615/2016 dhe nr. 426/2018 respektivisht me vendimet nr. 634, datë 4.1.2024 dhe nr. 606, datë 21.10.2024) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka vendosur kthimin e akteve



prokurorit dhe aktualisht këto procedime penale janë në hetim dhe dy (nr. 234/2019 dhe nr. 568/2017) ende nga gjykata nuk është konkluduar me vendim përfundimtar për këto çështje.

Gjithashtu nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, është dërguar regjistri elektronik i procedimeve penale për vitin 2019, analizat vjetore të kësaj prokurorie për vitet 2021, 2022 dhe 2024 dhe informacion mbi prokurorët dhe periudhat që secili prej tyre ka pasur në hetim çdo procedim përkatës, si dhe kopje të dosjeve hetimore të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për 21 procedime penale, me përjashtim të procedimeve penale nr. 615/2016, nr. 426/2018 të cilat ende janë në hetim dhe procedimit penal nr.234/2019 i cili ndodhej ende në fazë shqyrtimi në seancë paraprake.

Me shkresën nr. 640/6 prot., datë 05.03.2025 të ILD-së, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, është kërkuar informacion dhe dokumentacion, mbi numrin e çështjeve penale të regjistruara, shqyrtuara dhe konstatuara nga gjykata të proceduara për herë të parë për pushim, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale, në periudhën 01.01.2024-31.12.2024; Vendimet gjyqësore, kërkesat e prokurorit për pushim dhe vendimet e prokurorit për pushim të çështjes penale, me shkak parashkrimin e ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Vendimet gjyqësore, nëse ka patur raste në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak i kërkesës së prokurorit ose i vendimit të pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024; Informacion dhe dokumentacion për rastet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatës që ka vendosur pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, kur shkak i pretenduar ka qenë për parashkrim të ndjekjes penale.

Me shkresën nr. 640/9 prot., datë 15.07.2025 të ILD-së, i është rikërkuar Gjykatës Berat informacioni dhe dokumentacioni për shkak të mosdërgimit të tij.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka dërguar informacion me shkresën nr. 1506/1 prot., datë 25.08.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/14 prot., datë 28.08.2025, sipas të cilit:

- Nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 janë paraqitur gjithsej 639 kërkesa në seancë paraprake. Në datën 01.01.2024 janë mbartur nga vitet e mëparshme 233 çështje seancë paraprake, gjithsej për gjykim kanë 872 kërkesa seancë paraprake nga të cilat 597 çështje janë pushuar dhe 28 çështje i janë kthyer prokurorisë për plotësim hetimi.
- Janë dërguar vendimet gjyqësore të pushimit, kërkesat e prokurorit për pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, dosjet e të cilave kanë qenë në



shqyrtim nga prokurorët gjatë vitit 2024 dhe janë paraqitur në gjykatë (Në lidhje me kërkesat e prokurorit janë përcjellë vendimet gjyqësore Nr. 396, 400, 414, 416, 469, 472, 491, 534, 540, 548, 554, 556, 563, 579, 591, 597, 600, 601, 602, 603, 605, 607, 616, 620, 621, 640, 651);

- Çështjet e tjera që janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi vepra penale është kryer shumë vite përpara dhe kanë qenë të pezulluara në prokurori.
- Gjatë vitit 2024 nuk ka patur raste të kthimit të akteve prokurorisë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë vitit 2024.

Me shkresën nr. 640/16 prot., datë 16.09.2025, ILD i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me kërkesë për kopje të njësuar me origjinalin të fashikujve gjyqësore të vendimeve të pushimit të çështjeve për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, të cilat janë paraqitur në gjykatë gjatë vitit 2024.

Me shkresën nr. 1861/1 prot., datë 23.09.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/21 prot., datë 25.09.2025, në përgjigje të shkresës nr. 640/16 prot., datë 16.09.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka dërguar kopjet e dosjeve gjyqësore dhe me shkresën nr. 1861/2 prot., datë 07.10.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 640/22 prot., datë 10.10.2025, në përgjigje të shkresës nr. 640/16 prot., datë 16.09.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka dërguar kopjet e dosjeve hetimore të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat që i përkasin vendimeve të pushimit për efekt të parashkrimit të 27 vendimeve të mësipërme.

Në bazë të të dhënave të dërguara nga kjo prokurori u konstatuan rastet e parashkrimit të ndjekjes penale në hetim, duke i grupuar procedimet penale në ato për të cilat janë shqyrtuar dosjet fizike të administruara të nënndara në procedime penale me autor me ose pa masë sigurimi dhe në procedime penale pa autor. Për këto procedime penale pasqyrohen prokurorët që kanë ndjekur hetimet me periudhat përkatëse për secilin dhe veprimet hetimore të kryera deri në veprimin e fundit. Në grupin e dytë bëjnë pjesë procedimet penale të cilat janë analizuar duke iu referuar vetëm vendimeve/kërkesave të prokurorit për pushim dhe vendimeve gjyqësore që kanë pranuar pushimin e çështjeve për shkak të parashkrimit, të cilat edhe këto janë nënndarë në procedime penale me autor dhe pa autor. Për këto procedime penale pasqyrohen prokurorët e ngarkuar me hetimin e tyre dhe periudhat për secilin prej tyre. Duke qenë se procedimet penale në të dyja grupet edhe pse janë parashkruar kanë mbetur sërish pa veprim, për secilin prej tyre është llogaritur edhe periudha që ka kaluar nga dita e parashkrimit deri në ditën e vendimit ose kërkesës për pushim nga prokurori. Ndërsa, lidhur me procedimet penale të pezulluara dhe të rifilluara për efekt parashkrimi të vëna në



dispozicion nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, janë konstatuar gjithsej 63 procedime penale, por që nuk janë objekt i këtij inspektimi.

- I. *Nga dosjet e procedimeve penale të parashkruara gjatë hetimit të vëna në dispozicion nga Prokuroria dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat rezulton se:*

***-Për procedimet penale me person ndaj të cilit zhvillohen hetimet:***

1) Procedimi penal nr. 995, datë 29.12.2016 i regjistruar për veprën penale “**Fshehja e të ardhurave**” të parashikuar nga neni 180 i K. Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale, shtetasin G. F.** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 162, datë 03.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i K. Penal, për shkak se afati i parashkrimit 5 vjet për këtë veprë penale është plotësuar në datën 29.12.2021. Po kështu vepra penale nuk përfshihet sipas paragrafit të tretë të saj, pra nuk ka pasoja të rënda sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

Referuar kërkesës për pushim në faqen dy të saj citohet “.....në përfundim të hetimeve OPGJ ka sugjeruar se mund të ketë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 179 i K. Penal dhe të dërgohet për gjykim për këtë veprë penale. Rezulton se është përpiluar vendimi për njoftimin e akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i K. Penal i datës 26.12.2017, si dhe akti i njoftimit të përfundimit të hetimeve që mban datën 29.01.2018. Të dyja këto akte rezultojnë se nuk janë nënshkruar nga prokurori i mëparshëm që hetonte çështjen. Në këtë rast mungesa e nënshkrimit të vendimit për njoftimin e akuzës, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm”...

Sipas rrethanave të çështjes vepra penale është kryer në datën 27.12.2016. Vepra penale e fshehjes së të ardhurave parashikuar nga neni 180/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte dënim me burgim deri në tre vjet dhe referuar nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezultojnë se sipas paragrafit të parë nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 27.12.2016 deri në datën 27.12.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 29.12.2016 deri në datë 13.05.2024 (procesverbal datë 5.5.2024 për dorëzimin e fashikullit të procedimit penal nr. 995/2016 nga prokuror Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim

prokurori)<sup>3</sup>, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 29.12.2021 (sipas kërkesës për pushim), pasi prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 13.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara ndaj personit që i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 11 muaj e 28 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 29.12.2016 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin shkurt 2018 (*urdhër delegimi i prokurorit Dritan Gripshi datë 22.2.2017, procesverbal marrje dokumenti datë 12.3.2017, certifikata personale në datën 14.4.2017, korrespondencë me D.R.Tatimore, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave datë 7.4.2017, datë 3.5.2017, datë 6.7.2017, datë 13.12.2017, dëshmi penaliteti datë 21.12.2017, relacion i OPGj datë 22.12.2017 për dërgimin në gjyq të procedimit penal, vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës i datës 26.12.2017 (i prokurorit Dritan Gripshi pa nënshkrim), ftesë për paraqitje datë 28.12.2017, procesverbal për marrje dokumenti datë 4.1.2018, urdhër për kërkim të pandehuri datë 18.01.2018, njoftimi i përfundimit të hetimeve datë 29.1.2018 (i prokurorit Dritan Gripshi pa nënshkrim), njoftim për caktim mbrojtësi 29.1.2018 (pa nënshkrim), përgjigje nr. 991, datë 25.2.2018 e Komisarariatit të Policisë). Gjithashtu fashikulli ka 4 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore që mbulojnë një periudhë prej 1 vit e 3 muaj hetime ndaj personit që i atribuohet vepra penale, duke filluar nga data 29.03.2017 (e para) deri në datë 29.12.2017 (e fundit) të prokurorit Dritan Gripshi të panënshkruara.*

2) Procedimi penal nr. 148, datë 27.02.2017 regjistruar për veprën penale të “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. K** (në dosje ka dhe një vendim pushimi datë 17.7.2017 të prokurorit Dritan Gripshi) është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 15.12.2024, miratuar me vendimin nr. 187 date 17.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a-1 të K.Penal për shkak se vepra penale është amnistuar dhe ndjekja penale për këtë vepër penale është parashkruar pasi vepra penale është kryer në datën 23.2.2016 dhe rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

<sup>3</sup> Me vendimin nr. 749, datë 27.3.2024 të KPK është vendosur shkarkimi nga detyra i prokurorit Dritan Gripshi, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

Vepra penale e ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a-1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim deri në një vit dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 23.2.2016 deri në datën 23.2.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 27.02.2017 deri në datë 13.05.2024 (*procesverbal për dorëzimin e fashikullit datë 6.5.2024 nga prokurori Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori*) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 23.2.2021, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara ndaj personit që i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet e 9 muaj e 18 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 27.2.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin korrik 2017 (*shkresa datë 4.4.2017 drejtuar Bashkisë, ZVRPP, Zyrës së Gjendjes Civile, vendim për ekspertim teknik datë 18.4.2017, ftesë për paraqitje datë 12.5.2017, procesverbal deklarimi i personit nën hetim datë 19.5.2017, relacion i OPGJ datë 14.7.2017, vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës datë 25.10.2017 të prokurorit Dritan Gripshi pa nënshkrim*). Gjithashtu ka 2 vendime zgjatje afati të hetimeve nga 3 muaj datë 27.5.2017 dhe 27.8.2017, të prokurorit Dritan Gripshi të pa nënshkruara.

3) Procedimi penal nr. 330, datë 04.05.2017 regjistruar për veprën penale të **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”** dhe **“Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”** të parashikuar nga neni 278 dhe 279 të K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasen L. Gj. është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 26.12.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal, për shkak amnistie dhe parashkrimit të ndjekjes penale, pasi kanë kaluar 3 vjet nga koha e kryerjes të veprës penale konstatuar në datën 3.5.2017 dhe me kërkesën e prokurorit të datës 26.12.2024, miratuar me vendimin nr. 123, datë 05.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 279/1 të K.Penal, pasi nga koha e kryerjes së veprës penale datë 3.5.2017 ka kaluar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër.

Vepra penale e parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila në kohën e kryerjes së saj dënohej me gjobë ose me burgim deri në dy vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 3.5.2017 deri në datën 3.5.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Gjithashtu vepra penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta", parashikuar nga neni 279/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, ndjekja penale është parashkruar me kalimin e 5 viteve në datën 3.5.2022.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 04.05.2017 deri në datë 17.04.2018<sup>4</sup> (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018<sup>5</sup> (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 10.02.2019 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 10.02.2019 deri në date 11.10.2021<sup>6</sup>, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit për veprën penale të mbajtjes pa leje të municionit në datën 3.5.2020; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023, i cili ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara të ndjekjes penale ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale nga data 4.5.2019, por edhe të parashkruar: Malvina Pëllumbi që ka hetuar dosjen në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 4 vjet 7 muaj e 23 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 4.5.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin qershor 2017, (*urdhër delegimi datë 5.5.2017 i prokurorit Ermir Beta, administrimi i aktit të ekspertimit teknik nr. 183 dhe nr. 184, datë 5.5.2017, akt ekspertimi teknik nr. 185, datë 10.5.2017, certifikata personale të datës 15.6.2017, procesverbal mbi dorëzimin e provave materiale datë 29.6.2017, dy deklarime nga persona që tregojnë rrethanat e hetimit të datës 29.06.2017, relacion datë 29.6.2017 i OPGJ dërguar me shkresën nr. 1008/2, datë 30.6.2017 prokurorit për pushimin e procedimit penal*). Gjithashtu fashikulli ka 7 vendime për zgjatje afati të hetimeve 3 mujore

<sup>4</sup> Me vendimin nr. 85, datë 15.3.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorit Ermir Beta i është pranuar kërkesa për dorëheqje nga detyra dhe është vendosur mbarimi i emërimit sipas dekretit nr. 5924, datë 6.11.2008.

<sup>5</sup> Me urdhrin nr. 116/I datë 17.9.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm prokurorit Artan Hazbi i është ndërprerë komandimi në Prokurorinë Berat dhe është kthyer në pozicionin e mëparshëm, atë të prokurorit në Prokurorinë Lushnjë.

<sup>6</sup> Me vendimin nr. 142, datë 27.4.2021 të KLP prokurori Olgert Rumnici është transferuar në Prokurorinë Krujë.

me të cilat është plotësuar afati 2 vjeçar i ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale, duke filluar nga data 28.07.2017 (e para) deri në datë 4.2.2018 nga prokurori Ermir Beta (3 vendime zgjatje afati), nga data 4.5.2018 deri në datën 4.8.2018 nga prokurori Artan Hazbi (2 vendime zgjatje afati), nga data 4.11.2018 deri në datën 04.02.2019 (vendimi për zgjatjen e fundit), nga prokurori Dritan Gripshi (2 vendime zgjatje afati të panënskruara prej tij).

4) Procedimi penal nr. 422, datë 13.06.2017 i regjistruar për veprën penale **“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”**, të parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, dhe nga data 18.10.2017 me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin P. G *(kërkuar pushimi me kërkesën e prokurorit të datës 18.9.2018 për shkak se mungojnë elementët e veprës penale dhe kthyer aktet për vazhdimin e hetimeve me vendimin nr. 434, datë 9.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat)* është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 15.12.2024, miratuar me vendimin nr. 110, datë 25.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, për shkak se ndjekja penale për këtë vepër është parashkruar, pasi kanë kaluar 5 vjet nga data e kryerjes së veprës në datën 19.5.2017.

Vepra penale e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga neni 290/2 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim nga një deri në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 19.5.2017 deri në datën 19.5.2022, nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim është parashkruar edhe ndjekja penale gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 22.05.2017 deri në datë 04.01.2019<sup>7</sup> (vendim për zëvendësim prokurori) duke mbajtur parasysh në këtë rast faktin se për një periudhë kohore dosja e procedimit penal ka qenë në gjykatë dhe në lidhje me të, me vendimin gjyqësor nr. 434, datë 9.11.2018 është vendosur kthimi i akteve prokurorit; Dritan Gripshi nga data 04.01.2019 deri në datë 13.05.2024 *(procesverbal dorëzimi i fashikullit datë 6.5.2025 nga prokurori Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori)*, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 19.5.2022, pasi dhe për afatin e mbetur prej 3 vjet e 4 muaj 14 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Çulli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili pasi ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara ndaj personit që i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të

<sup>7</sup> Me urdhrin nr. 247, datë 13.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm prokurori Olgert Rumnici është caktuar përkohësisht prokuror në Prokurorinë Shkodër.

parashkruar, ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 6 muaj e 24 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas vendimit të gjykatës nr. 434, datë 9.11.2018 për kthimin e akteve prokurorit për kryerjen e një rikspertimi autoteknik, nuk janë kryer veprime të tjera hetimore/procedurale.

5) Procedimi penal nr. 568, datë 17.08.2017 regjistruar për veprën penale "**Plagosja e rëndë me dashje**", të parashikuar nga neni 88/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin I. P** (me masë sigurimi "arrest në burg me afat 30 ditë" dhe nga data 18.9.2017 me masë sigurimi "detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore") është kërkuar pushimi me kërkesën e prokurorit të datës 16.09.2024, pas ndryshimit të cilësimit juridik të faktit në veprën penale "Plagosja e rëndë nga pakujdesia" parashikuar nga neni 91 i K. Penal pasi është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të kësaj vepre, si dhe kanë kaluar afatet tërësore të hetimeve. Kërkesa për pushim është në fazë shqyrtimi në seancë paraprake.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale ka ndodhur në datën 16.8.2017. Vepra penale e parashikuar nga neni 88/1 i K.Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet dhe në bazë të nenit 66 shkronja c) të K.P afati i parashkrimit është 10 vjet, afati i cili aktualisht nuk është plotësuar. Ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 91 i K.Penal përbën kundërvajtje penale, e cila parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në një vit dhe në bazë të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, afati i parashkrimit është 3 vjet, afati i cili është plotësuar në datën 16.8.2020.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 17.08.2017 deri në datë 26.09.2017<sup>8</sup> (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018<sup>9</sup> (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 16.8.2020 pasi nga prokurori edhe për afatin e mbetur prej 2 vjet 6 muaj e 23 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes penale për këtë shkak pas 4 vjet e 1 muaj nga dita e parashkrimit.

<sup>8</sup> Me vendimin nr. 189, date 19.9.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm prokurori Gentian Habazaj është transferuar në Prokurorinë Kavajë.

<sup>9</sup> Me vendimin nr. 37, datë 19.1.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm prokurorit Andi Pogaçe i është ndërprerë komandimi në Prokurorinë Berat dhe është kthyer në pozicionin e mëparshëm atë të prokurorit në Prokurorinë Fier.



Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 17.8.2017, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin nëntor 2017 (*akti mjekoligjor nr. 204, datë 25.8.2017 i administruar në datën 4.9.2017, kërkesë për caktim mase sigurimi datë 18.9.2017, apellim i prokurorit datë 18.9.2017, urdhër ekzekutimi datë 18.9.2017, dy procesverbale deklarimi të datës 24.11.2017, procesverbale për zbatimin e masës së sigurimit deri në datën 28.11.2017, relacion i OPGJ datë 30.11.2017 për marrjen të pandehur të shtetasit I. P, për veprën penale të plagosjes së rëndë nga pakujdesia*). Gjithashtu fashikulli ka një vendim zgjatje afati të hetimeve tre mujore të datës 15.11.2017, gjatë periudhës që dosja ishte në hetim nga prokurori Andi Pogaçe.

6) Procedimi penal nr. 719, datë 20.09.2017 regjistruar për veprën penale “**Shkatërrimi i pronës**” të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin N. M** është pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, pasi në datën 20.09.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e shkatërrimit të pronës, parashikuar nga neni 150 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 20.9.2017 deri në datën 20.9.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 20.09.2017 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 20.9.2022, pasi prokurori edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afate hetimore të përfunduara të ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale pas 1 vit 10 muaj e 11 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale në datën 20.9.2017, nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale. Gjithashtu fashikulli ka 3 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore,

duke filluar nga data 20.12.2017 (e para) deri në datë 20.06.2018 (e fundit) nga prokurorët Ermir Beta dy zgjatjet e para dhe Artan Hazbi zgjatja e fundit.

7) Procedimi penal nr. 913, datë 08.11.2017, i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”** të parashikuar nga neni 161 i K.Penal **me person të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin E. B.**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 24.05.2024, miratuar me vendimin nr. 591, datë 15.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i K.Penal pasi në datën 08.11.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e parashikuar nga neni 161 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 8.11.2017 deri në datën 8.11.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 08.11.2017 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 8.11.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet e 1 muaj e 18 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 viti 6 muaj e 16 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 8.11.2017, nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale. Gjithashtu fashikulli ka 3 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore, duke filluar nga data 08.02.2018 (e para) dhe në datë 08.05.2018 nga prokurori Ermir Beta dhe në datën 08.05.2018 deri në datën 30.07.2018 (e fundit) nga prokurori Artan Hazbi.

8) Procedimi penal nr. 1065, datë 24.12.2017 i regjistruar për veprën penale **“Ruajtja dhe depozitimi i mallrave që janë kontrabandë”** të parashikuar nga neni 179 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin L. B.**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 24.12.2024, miratuar me vendimin nr. 155, date 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar

nga neni 179/1 i K.Penal për shkak se nga data e kryerjes së veprës 12.12.2017 është plotësuar afati i parashkrimit në datën 12.12.2022, pasi kanë kaluar mbi 5 vjet nga ndodhja e faktit penal.

Vepra penale e parashikuar nga neni 179/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 12.12.2017 deri në datën 12.12.2022, nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 14.12.2017 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datë 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 12.12.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 2 muaj e 13 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet e 12 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 24.12.2017, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin qershor 2019 (*urdhër delegimi datë 29.12.2017 i prokurorit Olgert Rumnici, korrespondencë datë 18.1.2018 me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, DRT dhe Njësinë Bashkiake, kthim përgjigje nga Njësia Bashkiake datë 29.1.2018, Drejtoria Përgjithshme e Doganave e datës 5.02.2018, DRT datë 6.2.2018, dëshmi penaliteti datë 21.2.2018, urdhër thirrje datë 22.5.2019, urdhër për kthim sendesh të sekuestruara dhe procesverbal për kthimin e sendeve të sekuestruara 10.06.2019, relacion i OPGJ datë 10.6.2019 për pushimin e procedimit penal*). Gjithashtu fashikulli ka 5 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore të cilat plotësojnë 1 vit e 6 muaj nga afati i ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale, duke filluar nga data 23.03.2018 (e para) deri në datë 28.03.2019 (e fundit) gjatë kohës që procedimi ka qenë në hetim nga prokurori Olgert Rumnici.

9) Procedimi penal nr. 1007, datë 04.12.2017 i regjistruar për veprën penale **“Braktisja e fëmijëve të mitur”** të parashikuar nga neni 124/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasen E. Z** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 15.12.2024, miratuar me vendimin nr. 107, datë 25.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 124/1 i

K.Penal, për shkak se vepra penale është kryer në datën 31.7.2017 dhe rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Vepra penale e parashikuar nga neni 124/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 31.7.2017 deri në datën 31.7.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 05.12.2017 deri në datën 13.05.2024 (*procesverbal dorëzimi i procedimit nr.1007/2017 në datën 6.5.2024 nga prokuror Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori*), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 31.7.2022, ku prokurori për 5 vjet e 2 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 4 muaj e 15 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 4.12.2017, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin prill 2018 (*korrespondencë me zyrën e gjendjes civile datë 19.1.2018, vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës i datës 27.04.2018 i prokurorit Dritan Gripshi i panënshkruar, njoftim për përfundimin e hetimeve pa datë dhe i pa nënshkruar*). Gjithashtu fashikulli ka l(një) vendim zgjatje afati të hetimeve 3 mujore nga prokurori Dritan Gripshi të panënshkruar duke filluar nga data 04.03.2018 deri në datën 04.06.2018.

**10) Procedimi penal nr. 1075, datë 28.12.2017, i regjistruar për veprën penale "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia", të parashikuar nga neni 161 i K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. B, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 129, datë 06.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i K. Penal, për shkak se ka kaluar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale të konstatuar në datën 12.7.2016.**

Rezulton se në referim të nenit 66, shkronja ç) të K. Penal, nga data e kryerjes së veprës penale të shkatërrimit të pronës nga pakujdesia në datën 12.7.2016, deri në datën 12.7.2021 kanë kaluar 5 vjet dhe si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 22.07.2016 deri në datë 09.10.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Ermir Beta nga data 09.10.2017 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 12.7.2021, pasi prokurori edhe për afatin e mbetur prej 2 vjet 9 muaj e 22 ditë, nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila pasi ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar për personin të cilit i atribuohet vepra penale dhe më tej të parashkruar ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet 5 muaj e 15 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 28.12.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin maj 2020 (*akti ekspertimit teknik i datës 25.05.2020*).

11) Procedimi penal nr. 33, datë 11.01.2018 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134 i K. Penal, **me emër personi që i atribuohet vepra penale shtetasin I. E.**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 620, datë 22.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.Penal (nuk përcaktohet paragrafi 1 ose 2, por referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda) pasi në datën 11.01.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte në tre paragrafët e tij përkatësisht dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet; me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 11.1.2018 deri në datën 11.1.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal, janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 11.01.2018 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 11.1.2023, pasi edhe për afatin



e mbetur prej 4 vjet 3 muaj e 21 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të parashkruar, ku ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak pas 1 vit 6 muaj e 20 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 11.1.2018, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin korrik 2018 (*urdhër për kthim sendi datë 24.5.2018, procesverbal për kthim sendi datë 25.5.2018, procesverbal i deklarimeve të datës 23.07.2018*). Gjithashtu fashikulli ka 2 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore, duke filluar nga data 11.04.2018 (e para) në emër të drejtuesit të prokurorisë (i panënshkruar) dhe në datë 11.07.2018 (e dyta), nga prokurori Artan Hazbi.

**12) Procedimi penal nr. 71, datë 29.01.2018 i regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” të parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin Sh. Sh (me masë sigurimi “arrest në burg me afat 30 ditë” dhe me vendimin nr. 33, datë 16.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është bërë revokimi i masës së sigurimit 30 ditor për të arrestuarin Sh. Sh duke e liruar nga burgun pa masë tjetër sigurimi), si dhe për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasit S. D, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 146, datë 18.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, pasi me kalimin e 5 viteve nga data kryerjes 28.1.2018, konstatohet parashkrimi i ndjekjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i K. Penal, konstatohet se nuk ka elementë të kësaj vepre penale pasi viktimë e veprës është vetë personi shkaktar i aksidentit.**

Vepra penale e drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt parashikuar nga neni 291 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim gjer në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 28.1.2018 deri në datën 28.1.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 29.01.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 28.1.2023, pasi edhe për afatin

e mbetur prej 1 vit 3 muaj e 17 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 10 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 29.1.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin prill 2018 (vendim për kryerjen e ekspertimit autoteknik datë 2.2.2018, akt ekspertimi autoteknik i datës 09.02.2018, akte ekspertimi mjekoligjor të adminstruara datë 19.2.2018, kthim përgjigje e Prokurorisë nr. 282/8, datë 26.4.2018). Gjithashtu fashikulli ka shtatë vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore nga prokurori Olgert Rumnici që mbulojnë një periudhë 2 vjeçare të ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale duke filluar nga data 29.04.2018 (e para) deri në datë 29.10.2019 (e fundit).

**13) Procedimi penal nr. 275, datë 21.04.2018 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, me person ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasen D. S është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 28.06.2024, miratuar me vendimin nr.556, datë 08.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 15.04.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.**

Vepra penale e parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 15.4.2018 deri në datën 15.4.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 17.04.2018 deri në datë 13.06.2024 (procesverbal dorëzimi i procedimit penal të datës 28.6.2024 nga prokurori Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 15.4.2023, pasi në këtë afat nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 13.06.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak, pas 1 vit 2 muaj e 13 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 21.4.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin nëntor 2018 (*urdhër delegimi datë 21.4.2018 i prokurorit Dritan Gripshi, vendim bashkimi i procedimeve penale datë 14.4.2021 për bashkimin e kallëzimit nr. 1414 datë 18.4.2018, procesverbal deklarimi datë 17.5.2018, procesverbal deklarimi datë 6.8.2018, dy procesverbale deklarimi datë 11.8.2018, procesverbal ballafaqimi datë 11.9.2018, procesverbal deklarimi datë 12.11.2018, vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës të pandehurës shtetases D. S i datës 15.11.2018 të prokurorit Dritan Gripshi, shkresë datë 15.11.2018 për dërgimin e dosjes së deleguar në prokurori).*

**14) Procedimi penal nr. 312, datë 04.05.2018 i regjistruar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a të K.Penal, me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin Q. K është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 14.05.2024, miratuar me vendimin nr. 386, datë 25.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, pasi në datën 19.04.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.**

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, nga data e kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm sipas paragrafit të parë në datën 19.4.2018 deri në datën 19.4.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 20.04.2018 (sipas procesverbalit të shortit elektronik datë 20.4.2018) deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë në të cilën është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 19.04.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 6 muaj e 8 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe me pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit e 25 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 4.5.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin maj 2020 (*urdhër delegimi datë 4.5.2018 i prokurorit Olger Rumnici, vendim ekspertimi teknik datë 2.10.2019, akt ekspertimi teknik i datës 25.05.2020, relacion i OPGj datë 13.2.2024 për pushimin e procedimit penal pasi ka përfunduar afati 2 vjeçar i hetimeve ndaj personit nën hetim në datën 4.5.2020*). Gjithashtu fashikulli ka 8 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore të

prokurorit Olger Rumnici duke filluar nga data 03.08.2018 (e para) deri në datë 04.05.2020 (e fundit) me të cilat është plotësuar afati 2 vjeçar i hetimit.

**15) Procedimi penal nr. 352, datë 10.05.2018 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134 te K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin E. H është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 18.10.2024, miratuar me vendimin nr. 681, datë 11.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, për shkak se vepra penale është konstatuar të paktën në datën 21.2.2018 dhe ndjekja penale është parashkruar pasi nga koha e kryerjes se veprës penale kanë kaluar mbi 5 vjet.**

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të vjedhjes sipas paragrafit të parë të nenit 134 të K.Penal në datën 21.2.2018, deri në datën 21.2.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 22.02.2018 deri në datën 17.04.2018; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datën 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 20.09.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 21.2.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 4 muaj e 10 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar për personin nën hetim por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 7 muaj e 27 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 10.5.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin dhjetor 2019 (*urdhër delegimi datë 23.5.2018 i prokurorit Artan Hazbi, procesverbal për marrjen e dokumenteve datë 6.12.2019, dy procesverbale deklarimi të datës 10.12.2019, raport shërbimi datë 10.12.2019, relacion i OPGJ datë 18.12.2019 për pezullimin e procedimit penal*) dhe më tej nuk ka veprime të tjera. Gjithashtu fashikulli ka 2 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore duke filluar nga data 10.08.2018 (e para) të prokurorit Artan Hazbi pa nënshkrim dhe datë 09.11.2018 (e fundit) të prokurorit Olgert Rumnici.

**16) Procedimi penal nr. 455, datë 13.06.2018 i regjistruar për veprën penale “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, me emër personi që i atribuohet vepra penale shtetasin V. Ç, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 29.07.2024, miratuar me vendimin nr. 616, datë 22.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të**

Përgjithshëm Berat, pasi në datën 13.06.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e dhunës në familje parashikuar nga neni 130/a-1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale parashikonte një dënim me burgim deri në dy vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 13.6.2018 deri në datën 13.6.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 28.5.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 13.6.2023, pasi prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 1 muaj 16 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale në datën 19.06.2018, nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale.

17) Procedimi penal nr. 615, datë 30.07.2018 i regjistruar për veprën penale "**Braktisja e fëmijëve të mitur**" të parashikuar nga neni 124 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin S. K.**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 142 datë 18.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 124/1 i K.Penal pasi nuk janë konsumuar elementët e anës objektive të veprës penale, si dhe rezulton se është parashkruar ndjekja penale me kalimin e 5 viteve nga kryerja e veprës penale të kallëzuar në datën 30.7.2018.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 11.7.2018. Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të braktisjes së fëmijëve të mitur sipas paragrafit të parë të nenit 124 të K.P në datën 30.7.2018 deri në datën 30.7.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 30.07.2018 deri në datë 13.05.2024 (*procesverbal dorëzimi i procedimit nga prokurori Dritan Gripshi në datën 5.5.2024, vendim për zëvendësim prokurori*), periudhë gjatë të cilës është parashkruar ndjekja penale në datën 30.7.2023, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë

person si të pandehur ose të përfundonte hetimet me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 13.05.2024 e në vazhdim e cila tashmë ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit nën hetim por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit e 4 muaj e 27 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal datë 30.7.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin dhjetor 2018 (*urdhër delegimi datë 30.7.2018 i prokurorit Dritan Gripshi, urdhër thirrje shtetasi dhe ftesë për paraqitje të datës 14.9.2018, shkresë Zyrës së Gjendjes Civile datë 14.9.2018, procesverbal i pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime datë 23.10.2018, procesverbal deklarimi datë 24.9.2018, kthim përgjigje e Komisarariatit të Policisë datë 06.12.2018, relacion i OPGJ datë 10.12.2018 për pushimin e procedimit penal*). Gjithashtu fashikulli ka 3 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore duke filluar nga data 30.10.2018 (e para) deri në datë 30.04.2019 (e fundit) të prokurorit Dritan Gripshi.

**18) Procedimi penal nr. 649, datë 30.08.2018 i regjistruar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 89 i K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin L. H (me kërkesën e datës 12.10.2018 prokuroria ka kërkuar miratimin e urdhrit penal dhe gjykata me vendimin nr. 329, datë 22.11.2018 ka vendosur refuzimin e miratimit të urdhrit penal dhe kthimin e akteve prokurorit të çështjes) është pushuar me vendimin e datës 12.12.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, pasi vepra penale është amnistuar. Vepra penale është kryer në datën 29.08.2018 dhe rezulton i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.**

Vepra penale e plagosjes së lehtë me dashje parashikuar nga neni 89 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila në kohën e kryerjes parashikonte dënim me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është 3 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 29.8.2018 deri në datën 29.8.2021 kanë kaluar 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur, e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Artan Hazbi nga data 30.08.2018 deri në datën 20.09.2018; Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 13.05.2024 (*procesverbali dorëzimi i fashikullit nga prokurori Dritan Gripshi në datën 6.5.2024, vendim për zëvendësim prokurori*) ku përfshihet edhe periudha që dosja e procedimit penal ka qenë në gjykatë dhe në lidhje me të është nxjerrë vendimi nr. 329, datë 22.11.2018 për refuzimin e urdhrit penal prej 5 vjet 5 muaj e 21 dite, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 29.8.2021, ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë person

si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar ndaj personit që i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe pas 6 muaj e 27 ditë ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit ose pas 3 vjet 3 muaj e 14 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit të hetimeve rezulton se pas vendimit të gjykatës nr. 329, datë 22.11.2018 për refuzimin e miratimit të urdhrit penal dhe kthimin e akteve prokurorit, nuk ka asnjë veprim tjetër hetimor/procedural.

**19) Procedimi penal nr. 656, datë 03.09.2018 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal me emër personi që i atribuohet vepra penale shtetasin N. T, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr.600, datë 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 03.09.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.**

Rezultoni se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 3.9.2018 deri në datën 3.9.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 03.09.2018 deri në datë 17.10.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olsian Çela nga data 17.10.2018 deri në datë 22.01.2019 (vendim për zëvendësim prokurori), përsëri nga prokurori Olgert Rumnici nga data 22.01.2019 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar edhe afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 3.9.2023 dhe se në afatin e mbetur prej 1 vit 10 muaj e 22 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar ndaj personit nën hetim por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohë prej 10 muaj e 15 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga fashikulli hetimor i vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 3.9.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin nëntor 2018 (*urdhër delegimi i datës 3.9.2018 i prokurorit Olgert Rumniçi, procesverbal deklarimi i datës 23.10.2018, vendim ekspertimi datë 12.11.2018, shkresë datë 19.11.2018 për dërgimin e dosjes së deleguar*). Gjithashtu fashikulli ka 8 vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore, duke filluar nga data 03.12.2018 (e para) në periudhën që çështja ishte në hetim nga prokurori

Olsian Çela, por në emër të drejtuesit të prokurorisë (pa nënshkrim) dhe nga data 3.3.2019 deri në datë 23.09.2020 (e fundit) nga prokurori Olgert Rumnici, me të cilat është plotësuar afati 2 vjeçar i hetimit ndaj personit nën hetim.

20) Procedimi penal nr. 707, datë 18.09.2018 i regjistruar për veprën penale “**Kanosja**” dhe “**Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta**” të parashikuara nga nenet 84 dhe 279/1 të K.Penal, **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin K. Gj** (me masë sigurimi detyrim paraqitje) është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 18.06.2024 për veprën penale të kanosjes dhe me kërkesën e prokurorit të datës 18.6.2024, miratuar me vendimin nr. 597, datë 17.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, pasi fakti nuk përbën vepër penale (nga akti ekspertimit teknik nr. 146 datë 20.09.2018 rezulton se mjeti prerës nuk kategorizohet si armë e ftohtë), të parashikuar nga neni 279/1 i K.Penal, ndërsa përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal pushohet për efekt të amnistisë penale.

Të dy veprat penale edhe pse janë pushuar për shkaqe të tjera, fillimisht janë parashkruar si vepra penale e kanosjes, e cila është parashkruar me kalimin e 3 viteve nga data e kryerjes ashtu dhe ajo e mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, e cila është parashkruar me kalimin e 5 viteve nga data e kryerjes.

Vepra penale e kanosjes parashikuar nga neni 84 i K. Penal, përbën kundërvajtje penale e cila në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në një vit dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 16.9.2018 deri në datën 16.9.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data 16.9.2018 e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 279/1 i K.Penal, deri në datën 16.9.2021 kanë kaluar 5 vjet e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 18.09.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 16.9.2021; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar ndaj personit që i atribuohet vepra penale por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak se fakti nuk përbënte vepër penale.

Nga fashikulli hetimor i vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 18.9.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin qershor 2019 (urdhër delegimi datë 18.9.2018 i prokurorit Olgert Runniçi, akt ekspertimi teknik datë 20.9.2018, vendim ekspertimi mjekoligjor datë 2.10.2018, kthim përgjigje Komisarati i Policisë datë 3.10.2018, akt ekspertimi mjekoligjor datë 4.10.2018, urdhër për kthim sendesh datë 9.10.2018, procesverbal kthimi i sendeve datë 11.10.2018, kërkesë për caktim mase sigurimi datë 16.10.2018, urdhër ekzekutimi datë 18.10.2018, ankim i prokurorit datë 22.10.2018, shkresë Bashkisë Kuçovë dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore datë 8.11.2018, vendimi për marrjen e personit të pandehur dhe njoftim akuze për K. Gj. datë 03.06.2019 dhe njoftimi për përfundimin e hetimeve i muajit qershor 2019 të prokurorit Olgert Runniçi të panjofuara). Gjithashtu fashikulli ka tetë vendime zgjatje afati të hetimeve 3 mujore, duke filluar nga data 18.12.2018 (e para) ne emër të drejtuesit të prokurorisë (i panëshkruar) dhe nga data 18.3.2019 deri në datë 23.09.2020 (e fundit) të prokurorit Olgert Runniçi, me të cilat plotësohet afati 2 vjeçar i hetimit ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale.

21) Procedimi penal nr. 787, datë 10.10.2018 i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”** të parashikuar nga neni 161 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasen Q. T** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 29.07.2024, miratuar me vendimin nr. 659, date 25.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i K.Penal, pasi në datën 10.10.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, ndërsa gjykata ka pranuar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. 787/2018 pasi nuk ka elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 161 i K.Penal.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 5.10.2018. Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të shkatërrimit të pronës nga pakujdesia në datën 10.10.2018 deri në datën 10.10.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 09.10.2018 deri në datë 02.05.2024 (procesverbal dorëzimi i fashikullit datë 16.4.2024 nga prokurori Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 10.10.2023, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar për personin nën hetim, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 9 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga aktet rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 10.10.2028 nuk është kryer asnjë veprim hetimor/procedural (*urdhër delegimi datë 9.10.2018 i prokurorit Dritan Gripshi, relacion i OPGJ datë 1.2.2022 për pushimin e procedimit penal pasi ka përfunduar në datën 10.10.2020 afati hetimor për personin nën hetim*).

22) Procedimi penal nr. 101, datë 15.02.2019 i regjistruar për veprën penale **“Plagosja e lehtë me dashje”** të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, **me emër personi të cilëve u atribuohet vepra penale shtetasit A. B, E. M dhe A. H** (*me masa sigurimi “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”*). *Më parë prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal me vendimin e datës 3.6.2019 dhe gjykata me vendimin nr. 229, datë 12.7.2019 ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve*) është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 12.12.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal pasi është amnistuar dhe për veprën penale të kryer në datën 14.2.2019 rezulton i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja d) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të plagosjes së lehtë me dashje në datën 14.2.2019 deri në datën 14.2.2022 kanë kaluar 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 15.02.2019 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 14.2.2022, ku prokurori edhe për afatin e mbetur nga vendimi gjykatës nr. 229, datë 12.7.2019 për kthimin e akteve prej 2 vjet 7 muaj e 2 ditë, nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale, por edhe të parashkruar dhe ka vendosur pushimin e çështjes për shkak amnistie dhe parashkrimi të ndjekjes penale pas 2 viteve 9 muaj e 28 ditë nga dita e parashkrimit.

Pas vendimit nr. 229, datë 12.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për kthimin e akteve prokurorit, rezulton se nuk ka asnjë veprim hetimor/procedural të kryer.

23) Procedimi penal nr. 257, datë 12.04.2019 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** në tentative të parashikuar nga neni 134 e 22 i K. Penal, **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin I. H** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 640, datë 11.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 e 22 të K. Penal (nuk përcaktohet paragrafi 1 apo 2) pasi në datën 12.04.2024 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.



Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal është krim, i cili nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasojë të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 12.4.2019 deri në datën 12.4.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 12.04.2019 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 12.4.2024, pasi nga prokurori për 5 vjet nuk është marrë asnjë si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, pas një kohe prej 3 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga fashikulli hetimor i vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal dhe emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale në datën 12.04.2019 nuk është kryer asnjë veprim hetimor/procedural (*urdhër delegimi datë 12.4.2019 i prokurorit Dritan Gripshi, relacion i OPGJ datë 10.03.2022 për pushimin e procedimit penal pasi ka kaluar afati 2 vjeçar i hetimit për personin në hetim I. H).*

**24) Procedimi penal nr. 260, datë 13.04.2019 i regjistruar për veprën penale “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 të K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin K. O. (me masë e sigurimi “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”) është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 173 datë 14.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, pasi është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale në datën 13.4.2024.**

*Sipas rrethanave të çështjes vepra penale është kryer në datën 12.4.2019. Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të dhunës në familje sipas paragrafit të parë në datën 12.4.2019 deri në datën 12.4.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 13.04.2019 deri në datë 02.05.2024 (*procesverbal dorëzimi i fashikullit datë 2.5.2024 nga prokurori Dritan Gripshi, vendim për zëvendësim prokurori*), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 13.4.2024 (sipas kërkesës së prokurorit për pushim), ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte

hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor (jo për shkak të parashkrimit); Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfundur dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe prej 3 muaj e 18 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 13.4.2019 nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale (*urdhër delegimi datë 13.4.2019 i prokurorit Dritan Gripshi, relacion i OPGJ datë 4.2.2022 për pushimin e procedimit penal pasi në datën 13.4.2021 ka përfunduar afati 2 vjeçar i hetimeve ndaj personit nën hetim*).

25) Procedimi penal nr. 704, datë 12.09.2019 i regjistruar për veprën penale **“Dhuna në familje”** të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin J. Sh** (*me masë sigurimit “deyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”*) është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 18.11.2024, miratuar me vendimin nr. 72 datë 13.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, për shkak se nga dita e ndodhjes së faktit penal datë 11.9.2019 kanë kaluar mbi pesë vite e për pasojë ndjekja penale është parashkruar.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të dhunës në familje sipas paragrafit të parë në datën 11.9.2019, deri në datën 11.9.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 12.09.2019 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 02.04.2024 deri në datë 04.09.2024; Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili pas 2 muaj e 14 ditë ka kërkuar pushimin e çështjes pasi në këtë periudhë është plotësuar afati i parashkrimit në datën 11.9.2024, ku edhe për afatin e mbetur prej 7 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor.

Nga fashikulli hetimor rezulton se nga data e regjistrimit të procedimit penal 12.9.2019 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin tetor 2020 (*urdhër delegimi i prokurorit Dritan Gripshi datë 12.9.2019, deklaram nga personi që ka dijeni për veprën penale datë 18.9.2020, relacion i OPGJ datë 24.9.2020 për dërgimin në gjyq të procedimit penal, urdhër kërkimi i të pandehurit datë 27.9.2020, vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës i prokurorit Dritan Gripshi (i panjostuar) dhe njoftim përfundimor hetimesh i datës 29.10.2020 të prokurorit Dritan Gripshi (i panjostuar), procesverbal shpenzimesh*

*procedurale datë 30.10.2020*). Gjithashtu fashikulli ka tre zgjatje afati të hetimeve nga 3 muaj secila, që mbulojnë një periudhë hetimi prej 9 muaj të personit të cilit i atribuohet vepra penale, duke filluar nga data 12.01.2020 (e para) deri në datë 12.07.2020 (e fundit) të pa nënshkruara nga prokurori Dritan Gripshi, ku midis tyre mungon një zgjatje afati nga data 12.12.2019.

**26) Procedimi penal nr. 497, datë 08.08.2020 i regjistruar për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” të parashikuar nga neni 236 i K.Penal, me emër personi të cilëve u atribuohet vepra penale shtetasit H. A, E. A, K. D dhe E. G (me masë sigurimi “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”) është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 17.07.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 236/1 i K.Penal pasi në datën 08.08.2023 është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.**

Vepra penale e kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik, parashikuar nga neni 236/1 i K. Penal, përbën kundërvajtje penale e cila në kohën e kryerjes parashikonte dënim me gjobë ose me burgim gjer në një vit dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim, afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 8.8.2020 deri në datën 8.8.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 08.08.2020 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datë 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 8.8.2023, ku prokurori edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 9 muaj e 27 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje që i kishte kaluar afati hetimor 2 vjeçar i ndjekjes penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pasi ka kaluar 11 muaj e 9 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga fashikulli hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 8.8.2020 nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale. Gjithashtu fashikulli ka 7 zgjatje afati të hetimeve 3 mujore për periudhën 2 vjeçare të ndjekjes penale ndaj personit që i atribuohet vepra penale, duke filluar nga data 06.11.2020 (e para) deri në datën 7.5.2021 të prokurorit Olgert Rumnici (3 zgjatje) dhe nga data 11.10.2021 deri në datën 06.05.2022 (e fundit) të prokurorit Adnan Hoxha (4 zgjatje).

- ***Për procedimet penale pa autor:***

1) Procedimi penal nr. 755, datë 27.09.2016 i regjistruar për veprën penale “**Shkatërrimi i pronës me eksploziv**” të parashikuar nga neni 152 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 25.10.2024, miratuar me vendimin nr. 643, datë 11.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 152/1 i K.Penal pasi nga koha e ndodhjes së faktit penal në datën 22.9.2016 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe është parashkruar ndjekja penale.

Vepra penale e shkatërrimit të pronës me eksploziv, parashikuar nga neni 152/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja ç) të K. Penale, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.9.2016 deri në datën 22.9.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 27.09.2016 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 20.09.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 22.9.2021, pasi edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet e 2 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri kur u zëvendësua nga prokurore Denisa Perdja që e hetoi deri në datë 04.09.2024 dhe nga prokuror Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet 1 muaj e 3 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga aktet rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal, në datën 27.9.2016, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin korrik 2018 (*urdhër delegimi datë 3.10.2016 i prokurorit Ermir Beta, dy procesverbale deklarimi datë 14.10.2016, kthim përgjigje të shoqërisë Vodafone të datës 1.11.2016, 22.12.2016, relacion i OPGj datë 29.3.2017 për pezullimin e procedimit penal, kthim përgjigje e shoqërisë Telekom datë 18.4.2017, procesverbale deklarimi datë 9.5.2018, datë 14.5.2018, datë 30.5.2018, kthim përgjigje të kompanisë Plus datë 24.5.2018, Albtelekom datë 30.5.2018, Telekom datë 18.6.2018, Vodafone datë 2.7.2018*).

2) Procedimi penal nr. 808, datë 14.10.2016 i regjistruar për veprën penale “**Mashtrimi në sigurime**” të parashikuar nga neni 145 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 25.11.2024, miratuar me vendimin nr. 26, date 22.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga

neni 145 të K.Penal, pasi vepra penale është kryer në vitet 1993-1998 (në dy raste deri në vitin 2015) dhe ndjekja penale për këtë vepër është parashkruar me kalimin e afatit 5 vjeçar.

Vepra penale e mashtrimit në sigurime parashikuar nga neni 145 i K. Penale është krim, i cili dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 31.10.2015 deri në datën 31.10.2020 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 17.12.2016 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 31.10.2020 dhe se në afatin e mbetur prej 3 vjet 10 muaj e 14 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 15.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); nga prokurore Denisa Perdja nga data 15.10.2023 deri në datë 04.09.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Arjeta Plaku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 4 vjet e 25 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga aktet rezulton se përveç veprimeve verifikuese të kryera për materialin kallëzues, pas regjistrimit të procedimit penal në datën 14.10.2016, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin tetor 2019 (*urdhër delegimi datë 14.10.2016 nga prokurori Olgert Rumnici, dy raporte shërbimi të datës 9.3.2017 në lidhje me urdhra thirrje të datës 28.2.2017, 2.3.2017, 9.3.2017, dy procesverbale deklarimi të datave 3.3.2017 dhe 13.03.2017, relacion i OPGj datë 20.7.2017 për pushimin e procedimit penal, kërkesë drejtuar DRSSH Berat datë 09.10.2019 dhe përgjigje e DRSSH Berat në datë 15.10.2019*).

3) Procedimi penal nr. 97, datë 10.02.2017 i regjistruar për veprat penale **“Vjedhja”** dhe **“Shkatërrimi i pronës”** të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 150 të K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr.603, datë 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 150 të K.Penal, pasi në datën 10.02.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezultoni se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprave penale të vjedhjes sipas paragrafit të parë dhe shkatërrimit të pronës në datën 20.2.2017 deri në datën 10.2.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 10.02.2017 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (*procesverbal dorëzimi i fashikullit nga prokurori Dritan Gripshi datë 16.4.2024*, vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 10.2.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 17 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe prej 2 vjet 5 muaj e 7 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor të vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 10.2.2017 veprimi i vetëm hetimor/procedural është kryer në muajin prill 2019 (*procesverbal deklarimi i datës 19.04.2019*).

4) Procedimi penal nr. 190, datë 13.03.2017 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 20.05.2024, miratuar me vendimin nr. 472, datë 16.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 09.03.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 9.3.2017 deri në datën 9.3.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 13.03.2017 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); prokurori Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); prokurori Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (*dorëzuar fashikulli nga prokurori Dritan Gripshi sipas procesverbalit datë 2.5.2024*, vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 9.3.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet 1 muaj e 16 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; prokurore Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak pas 2 vjet e 2 muaj e 11 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor të vënë në dispozicion rezulton që pas regjistrimit të procedimit penal në datën 13.3.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin gusht 2017

(urdhër delegimi datë 13.3.2017 i prokurorit Gentian Habazaj, shkresa datë 31.5.2017, datë 30.6.2017, datë 24.7.2017 (kërkesë të dhënash kompanisë celulare), kthim përgjigje të kompanive celulare në datat 21.6.2017, 13.7.2017, 28.7.2017, shkresë datë 22.8.2017 për dërgimin e dosjes së deleguar në prokurori).

5) Procedimi penal nr. 233, datë 29.03.2017 regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 30.07.2024, miratuar me vendimin nr. 607, datë 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 29.03.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 29.3.2017 deri në datën 29.3.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 29.03.2017 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018; Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (procesverbal dorezimi i dosjes nga Dritan Gripshi datë 16.4.2024, vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 29.3.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet 2 muaj e 4 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak, pas një kohe prej 2 vjet 4 muaj e 1 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor të vënë në dispozicion rezulton pas regjistrimit të procedimit penal në datën 29.3.2017 nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale.

6) Procedimi penal nr. 354 datë 15.05.2017 i regjistruar për veprën penale **“Mjekimi i pakujdesshëm”** të parashikuar nga neni 96 te K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 12.12.2024, miratuar me vendimin nr. 58 datë 10.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 96/2 i K.Penal, pasi ngjarja ka ndodhur në datën 27.9.2016 dhe deri në datën 27.9.2019 është plotësuar afati i parashkrimit me kalimin e 3 viteve.

Vepra penale e mjekimit të pakujdesshëm, parashikuar nga neni 96/2 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet, ndërsa me ndryshimet me ligjin nr.44/2019, datë 18.7.2019 “Neglizhenca në trajtimin

mjekësor” sipas paragrafit të dytë, parashikon një dënim me burgim deri në dy vjet, kështu që në referim të nenit 66, shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet dhe jo 3 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 27.9.2016 deri në datën 27.9.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 10.03.2017 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 27.9.2021, pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet 6 muaj e 17 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datë 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe prej 2 vjet 7 muaj e 2 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit penal rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 15.5.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin prill 2020 (vendim sekuestrimi datë 28.6.2017, kthim përgjigje nga DRSpitalit Kuçovë datë 10.7.2017, procesverbal sekuestrimi datë 20.7.2017, urdhër thirrje datë 13.9.2017, procesverbal sekuestrimi datë 15.9.2017, procesverbal deklarimi datë 25.9.2017, urdhër thirrje datë 26.10.2017, procesverbale deklarimi datë 1.11.2017, urdhër thirrje datë 11.12.2017, procesverbal deklarimi datë 18.12.2017, vendim për ekspertim mjekoligjor datë 17.7.2018, akt ekspertimi mjekoligjor datë 15.01.2019, akt ekspertimi mjekoligjor i administruar në datën 21.1.2019, shkresë datë 22.10.2019, procesverbal deklarimi i datës 26.11.2019, kthim përgjigje nga DRSpitalit Kuçovë datë 4.12.2019, urdhër thirrje datë 10.1.2020, kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë datë 14.2.2020, relacion i opgj datë 10.04.2020 për njoftimin e akuzës dhe dërgimin për gjykim).

7) Procedimi penal nr. 451, datë 21.06.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 20.05.2024, miratuar me vendimin nr. 469, date 16.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 të K.Penal, pasi në datën 21.06.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezultoni se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.6.2017 deri në datën 21.6.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.



Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 21.06.2017 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 21.6.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 4 muaj e 28 ditë, nuk është marrë asnjë person si pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë dosjen të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak pas 1 vit 10 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 21.06.2017, nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale.

8) Procedimi penal nr. 455, datë 24.06.2017 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 20.05.2024, miratuar me vendimin nr.554, date 07.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 24.06.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 24.6.2017 deri në datën 24.6.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 24.06.2017 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 24.6.2022, ku edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 4 muaj e 28 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila duke marrë një dosje tashmë të parashkruar ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit. Dosja e parashkruar ka mbetur pa veprim nga dita e parashkrimit edhe për 1 vit 10 muaj e 26 ditë.

Referuar fashikullit hetimor të vënë në dispozicion rezulton që pas regjistrimit të procedimit penal në datën 24.6.2017 nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale (*urdhër delegimi datë 24.6.2017 i prokurorit Gentian Habazaj, shkresë datë 22.9.2017 për dërgimin e dosjes së deleguar*).



9) Procedimi penal nr. 531, datë 27.07.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 11.07.2024, miratuar me vendimin nr. 534, date 26.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal pasi në datën 27.7.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 26.7.2017. Nga data e kryerjes së kësaj vepre penale, deri në datën 26.7.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 27.07.2017 deri në datë 16.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë në të cilën është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 27.7.2022 (sipas kërkesës për pushim), pasi për 5 vjet nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 16.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak pas 1 vit 11 muaj 15 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 27.7.2017, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin shkurt 2018 (*urdhër delegimi datë 27.7.2017 dhe 25.10.2017 i prokurorit Dritan Gripshi, urdhër për thirrje shtetasi datë 10.1.2018, procesverbal deklarimi i datës 19.01.2018, relacion i OPGJ datë 2.2.2018 për pezullimin e procedimit penal*).

10) Procedimi penal nr. 872, datë 26.10.2017i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr. 605, datë 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal pasi në datën 26.10.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 26.10.2017 deri në datën 26.10.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 26.10.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 23.01.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë

gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 26.10.2022 pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 15 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 6 muaj e 21 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 26.10.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin dhjetor 2017 (*urdhër delegimi datë 9.11.2017 i prokurorit Andi Pogaçe, urdhër delegimi datë 5.1.2018 i prokurorit Andi Pogaçe, vendim për kqyrjen e personit datë 19.1.2018, vendim ekspertimi vlerësim dëmi datë 20.11.2017, akt ekspertimi vlerësues dëmi datë 20.11.2017, raport shërbimi datë 23.11.2017, urdhër për shpërblim eksperti datë 10.12.2017, vendim ekspertimi daktiloskopik datë 15.12.2017, akt ekspertimi daktiloskopik administruar datë 29.12.2017*).

11) Procedimi penal nr. 979, datë 30.11.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 29.07.2024, miratuar me vendimin nr.601, datë 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 30.11.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 30.11.2017, deri në datën 30.11.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 30.11.2017 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 30.11.2022, ku nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas një kohe prej 1 vit 7 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 30.11.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin shkurt 2018 (*urdhër delegimi datë 4.12.2017 i prokurorit Dritan Gripshi, procesverbal deklarimi i datës 24.01.2018, relacion i OPGJ datë 07.02.2018 për dërgimin e akteve pranë prokurorit të çështjes Dritan Gripshi, pasi janë zbuluar autorët e veprës penale, shkresë datë 8.2.2018 për dërgimin e dosjes së deleguar në prokurori*).

**12)** Procedimi penal nr. 1038, datë 18.12.2017 regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr.602, date 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal pasi në datën 18.12.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezultoni se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 18.12.2017, deri në datën 18.12.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 18.12.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 23.01.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 18.12.2022, pasi dhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 2 muaj e 7 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 6 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

Referuar fashikullit hetimor rezultoni se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 18.12.2017 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin tetor 2018 (*urdhër delegimi datë 25.12.2017 i prokurorit Andi Pogaçe, shkresa datë 27.7.2018 dhe 8.10.2018 (kërkim të dhënash kompanive celulare), shkresë dërgim dosje e deleguar në prokurori datë 22.1.2018 dhe datë 7.9.2018, kthim përgjigje të shoqërive celulare datë 6.8.2018, datë 1.10.2018, vendim ekspertimi ekonomik i datës 03.10.2018, akt ekspertimi datë 15.10.2018*).

**13)** Procedimi penal nr. 1098, datë 29.12.2017 i regjistruar për veprën penale **“Vrasja nga pakujdesia”** të parashikuar nga neni 85 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 10.10.2024, miratuar me vendimin nr. 666, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 85 i K.Penal, pasi vepra penale është kryer rreth 7 vjet më parë dhe ndjekja penale është parashkruar me kalimin e 5 viteve nga data e kryerjes së saj.

*Nga rrethanat e çështjes rezultoni se ajo ka ndodhur në datën 27.12.2017. Vepra penale e vrasjes nga pakujdesia, e parashikuar nga neni 85 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në*

pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 27.12.2017 deri në datën 27.12.2022, nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim përveç plotësimit të afatit dy vjeçar të hetimit ndaj personit që i atribuohet vepra penale, është parashkruar edhe ndjekja penale gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 29.12.2017 deri në datë 03.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 27.12.2022 ku prokurori për 4 vjet 11 muaj e 28 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 03.05.2024 deri në datë 04.09.2024<sup>10</sup>; Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe 1 vit 9 muaj e 13 ditë nga dita e parashkrimit.

Pas regjistrimit të procedimit penal në datën 29.12.2017 rezulton se janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin shtator 2018 (*urdhër delegimi datë 5.1.2018 i prokurorit Dritan Gripshi, akt ekspertimi mjekoligjor i administruar në datën 5.2.2018, procesverbale deklarimi të datës 2.2.2018, 18.2.2018, 28.02.2018, relacion i OPGJ datë 27.8.2018 për pushimin e procedimit penal, urdhër për kthimin e sendit datë 3.9.2018, procesverbal eksperimenti hetimor datë 7.9.2018, vendim për kryerje ekspertimi autoteknik datë 11.9.2018*).

**14)** Procedimi penal nr. 31, datë 11.01.2018 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 11.07.2024, miratuar me vendimin nr. 540, datë 30.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, për shkak se në datën 11.01.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 11.1.2018, deri në datën 11.1.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 11.01.2018 deri në datë 17.04.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë në të cilën është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 11.1.2023 pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 3 muaj 21 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të

<sup>10</sup> Me vendim të KLP nr. 115, datë 18.7.2024 prokurore Denisa Perdja është transferuar në Prokurorinë Lezhë.

përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak, pas 1 vit e 6 muaj nga dita e parashkrimit

Referuar fashikullit hetimor të vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 11.01.2018, nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale.

**15)** Procedimi penal nr. 102, datë 09.02.2018 i regjistruar për veprën penale "**Vjedhja**" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 23.05.2024, miratuar me vendimin nr. 414, date 02.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.Penal (nuk përcaktohet paragrafi 1 ose 2) pasi në datën 09.02.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 9.2.2018 deri në datën 9.2.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 09.02.2018 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 09.02.2023, pasi nga prokurori brenda këtij afati nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; prokurore Albjona Papajani nga data 13.05.2024 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka paraqitur kërkesën për pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit e 3 muaj e 14 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 9.2.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin nëntor 2018 (*urdhër delegimi datë 13.2.2018 i prokurorit Dritan Gripshi, vendim bashkimi datë 11.07.2018 për bashkimin e procedimit penal nr. 102/2018 (hetuar nga Dritan Gripshi) me procedimin penal nr. 314/2018 (hetuar nga Olgert Runnici) në një procedim të vetëm me nr. 102/2018, vendim ekspertimi vlerësues datë 3.10.2018, akt ekspertimi datë 15.10.2018, procesverbal deklarimi i datës 02.11.2018.*

**16)** Procedimi penal nr. 482, datë 22.06.2018 i regjistruar për veprën penale "**Vjedhja**" të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr.579, datë 14.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1

i K.Penal, pasi në datën 22.06.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.6.2018 deri në datën 22.6.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 21.06.2018 deri në datë 23.11.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.11.2018 për një periudhë derisa është zëvendësuar nga prokurore Denisa Perdja (nuk ka vendim zëvendësimi), gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 22.6.2023; Denisa Perdja e cila pasi ka marrë dosjen të parashkruar ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak, pas 1 vit 1 muaj e 9 ditë.

Nga fashikulli hetimor i vënë në dispozicion rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 22.6.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin tetor 2018 (*procesverbal deklarimi datë 18.6.2018, procesverbal deklarimi datë 19.6.2018, urdhër delegimi datë 22.6.2018 i prokurorit Olgert Rumnici, procesverbal deklarimi datë 24.6.2018, procesverbal deklarimi datë 25.6.2018, procesverbal deklarimi datë 25.6.2018, procesverbal ballafaqimi datë 4.9.2018, procesverbal ballafaqimi datë 24.9.2018, shkresa datë 3.10.2018 (kërkim të dhënash kompanive celulare), kthim përgjigje të shoqërive telefonike datë 12.10.2018, datë 15.10.2018, vendim për kryerje ekspertimi traseologjik datë 28.10.2018, akt ekspertimi traseologjik datë 29.10.2018*).

**17) Procedimi penal nr. 763, datë 03.10.2018 i regjistruar për veprat penale "Shkatërrimi i pronës" dhe "Pushtimi i tokës"** të parashikuara nga nenet 150 dhe 200 të K.Penal, **pa autor**, është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 15.05.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, pasi në datën 22.09.2023 është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale dhe me kërkesën prokurorit të datës 15.05.2024, miratuar me vendimin nr. 400, datë 25.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 150 të K.Penal, pasi në datën 22.09.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e pushtimit të tokës, parashikuar nga neni 200 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.9.2018 deri në datën 22.9.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Gjithashtu në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të shkatërrimit të pronës në datën 20.9.2017 deri në datën 20.9.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 21.09.2018 (sipas procesverbalit të shortit manual datë 21.09.2018) deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të veprës penale të pushtimit të tokës në datën 22.9.2021, pasi prokurori gjatë këtij afati nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të veprës penale të shkatërrimit të pronës në datën 22.09.2023, pasi dhe për afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj e 11 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për këtë shkak, pas 7 muaj e 23 ditë nga dita e parashkrimit.

Nga shqyrtimi i materialit ka rezultuar se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 3.10.2018 janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin prill 2020 (*urdhër delegimi datë 3.10.2018 i prokurorit Olgert Rumnici, procesverbal deklarimi datë 24.6.2019, shkresa të datave 27.6.2019 dhe 17.09.2019 drejtuar Gjykatës, kthim përgjigje të Gjykatës datë 23.9.2019, relacion i OPGJ datë 24.9.2019 për pushimin e procedimit penal, akt ekspertimi teknik i datës 20.03.2020 administruar në datën 6.4.2020*).

**18)** Procedimi penal nr. 860, datë 05.11.2018 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr.548, datë 04.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal pasi në datën 05.11.2023 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 5.11.2018, deri në datën 5.11.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 29.10.2018 (sipas procesverbalit të shortit manual të datës 29.10.2018) deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën

5.11.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 23 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor.

Nga fashikulli hetimor ka rezultuar se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 5.11.2018, janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin korrik 2019 (*urdhër delegimi datë 5.11.2018 i prokurorit Olgert Rumnici, dy procesverbale deklarimi të datave 28 dhe 29 Qershor 2019, si dhe sugjerimi i OPGJ për pushimin e procedimit penal datë 29.06.2019 prokurorit Olgert Rumnici, shkresë datë 1.7.2019 për dërgimin e dosjes së deleguar*).

**19)** Procedimi penal nr. 245, datë 08.04.2019 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 15.05.2024, miratuar me vendimin nr. 416, datë 02.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pasi në datën 15.03.2024 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 15.3.2019, deri në datën 15.3.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 20.3.2019 (sipas procesverbalit të shortit elektronik datë 20.3.2019) deri në datë 11.10.2021 (kohë kur është transferuar). Në fashikull është vetëm një vendim për zëvendësim prokurori, i datës 05.10.2023 ku prokurori Ledion Tema është zëvendësuar nga prokurore Denisa Perdja, e cila ka hetuar këtë procedim në vazhdim, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 15.3.2024, ku edhe për afatin e mbetur prej 5 muaj e 10 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor.

Referuar fashikullit hetimor rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal në datën 08.04.2019 nuk janë kryer veprime hetimore/procedurale (*urdhër delegimi datë 15.4.2019 i prokurorit Olgert Rumnici*).

**20)** Procedimi penal nr. 551, datë 23.07.2019 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a/3 të K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 28.10.2024, miratuar me vendimin nr. 667 datë 27.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/3 i K.Penal, pasi vepra penale është konstatuar të paktën në datën 13.7.2019 dhe është parashkruar ndjekja penale pasi nga koha e kryerjes se veprës penale kanë kaluar mbi 5 vjet.

Vepra penale e ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a-3 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim nga një deri në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 13.7.2019 deri në datën 13.7.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 15.07.2019 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, ku gjatë kësaj periudhe është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 13.7.2024, pasi dhe në kohën e mbetur prej 9 muaj e 1 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor duke kërkuar pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit pas 3 muaj e 15 ditë nga dita e parashkrimit.

Pas regjistrimit të procedimit penal në datën 23.7.2019 rezulton se janë kryer veprime hetimore/procedurale deri në muajin shkurt 2021 (*procesverbal për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime datë 16.9.2019, procesverbal për marrjen e provës datë 16.9.2019, korrespondencë me Bashkinë Berat 1.10.2019 dhe datë 9.10.2019, vendim për kryerjen e ekspertimit teknik vlerësues datë 25.2.2020, korrespondencë me ASHK datë 2.3.2020 dhe 2.12.2020, vendim për kryerjen e ekspertimit teknik datë 2.12.2020, akt ekspertimi topografik i datës 03.02.2021, relacion i OPGj datë 10.2.2021 për dërgimin e çështjes për gjykim*).

21) Procedimi penal nr. 932, datë 24.12.2021 i regjistruar për veprat penale "**Falsifikimi i dokumenteve**" dhe "**Mashtrimi në kredi**" të parashikuara nga nenet 186 dhe 146 të K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 651, datë 14.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 146 të K.Penal pasi është konstatuar se vepra penale ka ndodhur në datë 27.11.2006 dhe është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Nga shqyrtimi i materialit ka rezultuar se gjatë hetimit është konstatuar se veprat penale janë kryer në vitin 2006 dhe për këto vepra penale ndjekja penale është parashkruar që para regjistrimit të procedimit penal e si rrjedhim nuk është në objektin e këtij inspektimi tematik.

II. *Lidhur me procedimet penale të analizuara mbi bazën e vendimeve/kërkesave për pushim të prokurorit dhe vendimeve gjyqësore kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:*

- *Për procedimet penale me person ndaj të cilit zhvillohen hetimet:*

1) Procedimi penal nr. 615, datë 24.08.2016 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. T** është kërkuar pushimi me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal për shkakun se në datën 24.08.2021 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra është kryer deri në datën 22.8.2016.* Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.8.2016 deri në datën 22.8.2021 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Me vendimin nr. 634, datë 04.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka kthyer aktet për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe dosja është në hetim.

2) Procedimi penal nr. 542, datë 02.08.2017 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin B. G** (me vendimin nr. 53, datë 7.2.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 25.2.2019), pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit , miratuar me vendimin nr. 179, date 14.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të parashkrimit për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/3 i K. Penal të konstatuar të paktën në datën 31.7.2017.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 31.7.2017, deri në datën 31.7.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 01.08.2017 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 31.7.2022, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 13.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 3 vjet 4 muaj e 27 ditë nga dita e parashkrimit.

3) Procedimi penal nr. 573 datë 22.08.2017 i regjistruar për veprën penale të “**Shkatërrim i pronës nga pakujdesia**” të parashikuar nga neni 161 te K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin B. M,** pushuar me kërkesën e datës 24.12.2024, miratuar

me vendimin nr. 280 date 24.06.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 18.8.2017 dhe se është parashkruar ndjekja penale pasi nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 18.8.2017, deri në datën 18.8.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Artan Hazbi nga data 22.08.2017 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 20.09.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datë 05.10.2023 periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 18.8.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 10 muaj e 7 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 4 muaj e 6 ditë nga dita e parashkrimit.

4) Procedimi penal nr. 900, datë 02.11.2017 i regjistruar për veprën penale "**Prodhimi i kundraligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore**", të parashikuar nga neni 288/a i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin V. S.** është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 31.07.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 288/a/1 i K.Penal, pasi në datën 02.11.2020 është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra është kryer në datën 1.11.2017. Vepra penale e parashikuar nga neni 288/a i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila në kohën e kryerjes parashikonte dënim me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 2.11.2017 deri në datën 2.11.2020 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 02.11.2017 deri në datën 17.04.2018 për një kohë prej 5 muaj e 15 ditë; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 2.11.2020 (sipas vendimit të pushimit), pasi prokurori dhe për afatin e mbetur prej 2 vjet 1 muaj e 12 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër

ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 viti 7 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

5) Procedimi penal nr. 961 datë 23.11.2017 i regjistruar për veprën penale “**Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore**”, të parashikuar nga neni 288/a/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin E. H** është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 15.12.2024 pasi në datën 23.11.2020 është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra është kryer në datën 21.11.2017.* Rezulton se në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal nga data e kryerjes së kundërvajtjes penale të prodhimit të kundërligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore në datën 23.11.2017, deri në datën 23.11.2020 kanë kaluar 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 23.11.2017 deri në datë 17.04.2018; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 23.11.2020 (sipas vendimit të pushimit) pasi edhe në afatin e mbetur prej 2 vjet, 2 muaj e 3 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje me afat-hetimor të përfunduar ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 4 vjet e 22 ditë nga dita e parashkrimit.

6) Procedimi penal nr. 858, datë 23.10.2017i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin Q. M,** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 14.11.2024, miratuar me vendimin nr. 103, datë 25.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, pasi vepra penale është amnistuar dhe është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të veprës penale të kryer në datën 22.10.2017.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, nga data e kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm sipas paragrafit të parë në datën 22.10.2017, deri në datën 22.10.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 23.10.2017 deri në datë 17.04.2018 ; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 22.10.2022, pasi prokurori edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet 1 muaj e 10 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 2 vjet e 22 ditë nga dita e parashkrimit.

7) Procedimi penal nr. 124, datë 19.02.2018 i regjistruar për veprën penale “**Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit**” të parashikuar nga neni 159/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin D. S.**, pushuar me vendimin e datës 23.12.2024 për shkak se vepra penale është amnistuar dhe ndjekja penale është parashkruar pasi nga koha e kryerjes se veprës penale në datën 19.2.2018, kanë kaluar mbi 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Vepra penale e parashikuar nga neni 159/1 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në dy vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 19.2.2018 deri në datën 19.2.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 19.02.2018 deri në datë 17.04.2018; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datë 20.09.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 20.09.2018 deri në datë 11.10.2021 periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 19.12.2021, pasi dhe në afatin e mbetur prej 2 vjet 4 muaj e 29 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023; Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet e 4 ditë nga dita e parashkrimit.

8) Procedimi penal nr. 331, datë 04.05.2018 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. A.**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 121 datë 05.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, pasi vepra

penale është amnistuar dhe ndjekja penale është parashkruar duke qenë nga koha e kryerjes se veprës penale të konstatuar në datën 3.5.2018, kanë kaluar mbi 5 vjet.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm në datën 3.5.2018 deri në datën 3.8.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 04.05.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 3.5.2023, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 02.05.2024 e në vazhdim e cila ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 7 muaj e 22 ditë nga dita e parashkrimit.

9) Procedimi penal nr. 426, datë 11.06.2018 i regjistruar për veprën penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga neni 291 i K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin E. Z, pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 606 date 21.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datën 11.06.2023 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale. *Nga rrethanat e ngjarjes rezulton se vepra është kryer në datën 10.06.2018.*

Me vendimin nr. 606, datë 21.10.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka kthyer aktet për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe dosja është në hetim.

10) Procedimi penal nr. 617 datë 30.07.2018 i regjistruar për veprën penale "**Plagosja e lehte me dashje**" të parashikuar nga neni 89 i K.Penal **me person të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin B. H** është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 18.11.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal pasi vepra penale është amnistuar dhe ndjekja penale është parashkruar duke qenë se ka kaluar afati tre vjeçar nga momenti i kryerjes së veprës penale në datën 28.7.2018, i cili është plotësuar në datën 28.7.2021.

Në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale datë 28.7.2018, deri në datën 28.7.2021 kanë kaluar tre vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 30.07.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të

cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 28.7.2021 ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), i cili tashmë ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar për personin nën hetim, por edhe të parashkruar; Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet 3 muaj e 16 ditë nga dita e parashkrimit.

**11) Procedimi penal nr. 224, datë 04.08.2018 i regjistruar për veprën penale "Transportim dhe tregtim i mallrave që janë kontrabandë" të parashikuar nga neni 178/2 i K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin E. D, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 21.06.2024, miratuar me vendimin nr. 437, datë 10.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 178/2 i K.Penal pasi për veprën penale të kryer në datën 8.3.2018 afati i parashkrimit të ndjekjes penale është plotësuar që më datë 8.3.2023.**

Vepra penale e parashikuar nga neni 178/2 i K. Penal është krim, e cila në kohën e kryerjes parashikonte dënim me burgim deri në pesë vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 8.3.2018 deri në datën 8.3.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 19.03.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datë 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 8.3.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 4 muaj e 27 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 05.10.2023 deri në datë 12.02.2024; Dritan Gripshi nga data 12.02.2024 deri në datë 13.05.2024; Albjona Papajani nga data 13.05.2024 e në vazhdim, e cila ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale ndaj personit nën hetim por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe prej 1 vit 3 muaj e 13 ditë nga dita e parashkrimit.

**12) Procedimi penal nr. 773, datë 05.10.2018 i regjistruar për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm" të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale, shtetasin A. H, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 25.11.2024, miratuar me vendimin nr. 43, datë 03.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 të K.Penal pasi**



vepra penale është amnistuar duke qenë se është kryer në datën 22.9.2018 dhe ka kaluar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, nga data e kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm sipas paragrafit të parë në datën 22.9.2018 deri në datën 22.9.2023 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 26.09.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 22.9.2023 pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj e 11 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila tashmë ka marrë dosjen me afat hetimor të përfunduar ndaj personit nën hetim, por edhe të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 viti 2 muaj e 3 ditë nga dita e parashkrimit.

13) Procedimi penal nr. 802 datë 16.10.2018 i regjistruar për veprën penale "**Shkatërrimi i pronës me zjarr**" të parashikuar nga neni 151/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin K. Th.** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 22.10.2024, miratuar me vendimin nr. 266, date 11.06.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i K.Penal, pasi nga koha e regjistrimit të procedimit penal në datën 16.10.2018 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe ndjekja penale është parashkruar.

*Sipas rrethanave të çështjes vepra penale është kryer/konstatuar në datën 29.09.2018. Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 13.10.2018, deri në datën 13.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 01.10.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 29.09.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj e 18 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 deri në datë 04.09.2024; Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili tashmë ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar por edhe të parashkruar dhe ka



kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 23 ditë nga dita e parashkrimit.

**14) Procedimi penal nr. 823, datë 24.10.2018 i regjistruar për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” të parashikuar nga neni 205 te K.Penal, me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. K,** pushuar me vendimin e datës 31.12.2024 me arsyetimin se vepra penale është referuar në datën 24.10.2018 dhe ndodhemi përpara faktit të parashkrimit të ndjekjes penale pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të veprës penale kanë kaluar mbi 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer deri në datën 21.10.2018. Vepra penale e parashikuar nga neni 205 i K. Penal kur nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.10.2018, deri në datën 21.10.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim, pas kalimit të afatit 2 vjeçar të hetimit ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, është parashkruar edhe ndjekja penale gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurori Dritan Gripshi nga data 24.10.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 21.10.2021, ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 3 vjet 2 muaj e 10 ditë nga dita e parashkrimit.

**15) Procedimi penal nr. 819, datë 30.10.2018 i regjistruar për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” të parashikuar nga neni 205 i K. Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. B,** pushuar me vendimin e datës 15.12.2024 për shkak se vepra penale është amnistuar dhe në datën 22.10.2021 rezulton i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.

Vepra penale e parashikuar nga neni 205 i K. Penal kur nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.10.2018 deri në datën 22.10.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim, pas kalimit të afatit 2 vjeçar të



hetimit ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale është parashkruar edhe ndjekja penale gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 23.10.2018 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 22.10.2021, ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet 1 muaj e 23 ditë nga dita e parashkrimit.

16) Procedimi penal nr. 169, datë 11.03.2019 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin M. V** është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 15.12.2024, miratuar me vendimin nr. 102, date 24.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a-1 i K.Penal pasi vepra penale është kryer në datën 6.3.2019 ku është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 6.3.2019 deri në datën 6.3.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 11.03.2019 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 6.3.2024, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar të ndjekjes penale dhe më pas edhe të parashkruar dhe që ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 9 muaj e 9 ditë nga dita e parashkrimit.

17) Procedimi penal nr. 397, datë 31.05.2019 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin G. S** (me vendimin nr. 465, datë 12.11.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve) është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 147 date 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, pasi në datën 31.05.2024 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.



Rezultoni se nga data e kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm sipas paragrafit të parë në datën 31.5.2019, deri në datën 31.5.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 24.05.2019 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 13.05.2024 e në vazhdim, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 31.5.2024, pasi edhe për afatin e mbetur prej 18 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor dhe për këtë shkak ka kërkuar pushimin e çështjes.

**18) Procedimi penal nr. 743 datë 24.09.2019 i regjistruar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, me person të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. F është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 31.07.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal për shkak se afati i parashkrimit të kësaj vepre penale 3 vjet rezultoi të jetë plotësuar në datën 24.9.2022.**

Rezultoni se në referim të nenit 66 shkronja d) të K. Penal nga data e kryerjes së veprës penale të plagosjes së lehtë me dashje në datën 24.9.2019 deri në datën 24.9.2022 kanë kaluar 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 15.08.2019 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 24.9.2022, pasi gjatë këtij afati nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim e cila ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar për personin të cilit i atribuohet vepra penale dhe të parashkruar dhe që ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit.

**19) Procedimi penal nr. 753, datë 01.12.2020 i regjistruar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 89 i K. Penal me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. S është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 14.11.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 të K.Penal pasi vepra penale është amnistuar dhe për veprën penale të kryer në datën 30.7.2020 rezultoi i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.**

Në referim të nenit 66 shkronja d) të K. Penal, rezultoi se nga data e kryerjes së veprës penale të plagosjes së lehtë me dashje në datën 30.7.2020, deri në datën 30.7.2023 kanë kaluar 3 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 03.08.2020 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 30.7.2023, ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë një dosje me afat hetimor të përfunduar ndaj personit që i atribuohet vepra penale por edhe të parashkruar dhe që ka vendosur pushimin e çështjes për amnisti dhe për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi ka kaluar 1 vit 3 muaj e 14 ditë nga dita e parashkrimit.

**20) Procedimi penal nr. 469, datë 21.07.2021 i regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”** parashikuar nga neni 161 i K.Penal **me emër personi të cilit i atribuohet vepra penale shtetasin A. S,** pushuar me kërkesën e datës 11.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 279, datë 24.06.2025 të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 3.10.2018 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezultoi se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 3.10.2018, deri në datën 3.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim është parashkruar dhe ndjekja penale gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 05.08.2021 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 3.10.2023, pasi dhe në afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj e 22 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 05.10.2023 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 2 muaj e 8 ditë nga dita e parashkrimit.

---

*- Për procedimet penale pa autor:*

1) Procedimi penal nr. 544, datë 26.07.2016 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor,** pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 574, date 14.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit 5 vjet në datën 26.07.2021. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para vjedhjes me pasoja të rënda.

*Sipas rrethanave të ngjarjes vepra penale ka ndodhur në datën 21.7.2016. Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.7.2016, deri në datën 21.7.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 26.07.2016 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 26.7.2021 (sipas kërkesës për pushim), ku edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet 6 muaj e 3 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 3 vjet e 5 ditë nga dita e parashkrimit.

2) Procedimi penal nr. 647, datë 01.09.2016 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 20.05.2024 miratuar me vendimin nr. 466, datë 16.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, pasi është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të veprës penale në datën 01.09.2021.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.7.2016, deri në datën 21.7.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 24.08.2016 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 1.9.2021, pasi dhe në afatin e mbetur 3 vjet 7 muaj e 8 ditë nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose përfundonte hetimet me një vendimmarrje tjetër ligjore; prokuror Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka marrë një dosje të parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 2 vjet e 8 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

3) Procedimi penal nr. 825, datë 18.10.2016 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 617, date 22.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit 5 vjet në datën 18.10.2021. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.

*Sipas rrethanave të ngjarjes vepra penale është kryer në datën 16.10.2016. Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 16.10.2016, deri në datën 16.10.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 18.10.2016 deri në datën 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 18.10.2021 (sipas kërkesës për pushim), ku prokurori ka pasur në dispozicion 3 vjet e 8 muaj e 25 ditë kohë për të marrë të pandehur ose për të përfunduar hetimet; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 2 vjet 9 muaj e 13 ditë nga dita e parashkrimit.

4) Procedimi penal nr. 871, datë 04.11.2016 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr. 571, date 14.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se është plotësuar afati i parashkrimit 5 vjet në datën 04.11.2021. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para vjedhjes me pasoja të rënda.

*Sipas rrethanave të çështjes vepra penale është kryer deri në datën 30.10.2016. Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 30.10.2016, deri në datën 30.10.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 01.11.2016 deri në datë 17.10.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olsian Cela nga data

17.10.2018 deri në datë 22.01.2019 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 22.01.2019 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 4.11.2021 (sipas kërkesës së prokurorit), ku prokurori ka pasur në dispozicion një kohë prej 23 ditë për të marrë të pandehur ose për të përfunduar hetimet; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas një kohe prej 2 vjet 8 muaj e 17 ditë, nga dita e parashkrimit.

5) Procedimi penal nr. 12, datë 10.01.2017 i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrim i pronës”** të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 27.12.2024, për shkak të parashkrimit pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të veprës penale në datën 13.08.2016 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 17.08.2016 deri në datë 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datë 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 13.8.2021, ku prokurori edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet 6 muaj e 20 ditë nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 3 vjet 4 muaj e 14 ditë nga dita e parashkrimit.

6) Procedimi penal nr. 52 datë 24.01.2017 i regjistruar për veprën penale **“Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”** të parashikuar nga neni 189 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 14.11.2024, miratuar me vendimin nr. 8, datë 20.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ndjekja penale për këtë veprë është parashkruar pasi vepra penale është kryer në datën 5.7.2010 dhe rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Vepra penale e parashikuar nga neni 189 i K. Penal është krim, i cili parashikon në tre paragrafët e tij përkatësisht dënim me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet; me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur vepra është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën sipas paragrafit të tretë, ku në nenin 66, shkronja c) të K. Penal parashikohen afate më të gjata të parashkrimit 10 vjeçare, rezulton sipas këtij paragrafi nga data e kryerjes 5.7.2010 deri në datën 5.7.2020 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale për këtë veprë penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak. Ndërsa, në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet

burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë të veprës penale, ky afat është plotësuar deri në datën 5.7.2015, para regjistrimit të procedimit penal e si rrjedhim nuk përbën objekt të analizës së këtij inspektimi.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 24.01.2017 deri në datën 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 10 vjeçar i parashkrimit në datën 5.7.2020, pasi edhe për afatin e mbetur prej 2 vjet 5 muaj e 12 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 4 vjet 4 muaj e 9 ditë nga data e parashkrimit.

7) Procedimi penal nr. 151, datë 28.02.2017 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 të K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 23.05.2024, miratuar me vendimin nr. 421 date 05.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit 5 vjet në datën 28.02.2022. Referuar vendimit unifikues pasoja e veprës penale nuk është e rëndë.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 28.2.2017, deri në datën 28.2.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 28.02.2017 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 28.2.2022, ku për 5 vjet prokurori nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 13.05.2024 e në vazhdim e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 2 vjet 2 muaj e 25 ditë nga data e parashkrimit.

8) Procedimi penal nr. 230 datë 28.03.2017 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 të K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 125 date 05.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të parashkrimit pasi nga koha e kryerjes se veprës penale të konstatuar në datën 24.3.2017 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal nuk ka rezultuar që të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 24.3.2017 deri në datën 24.3.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 23.08.2017 deri në datën 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 24.3.2022, ku prokurori dhe për afatin e mbetur prej 4 vjet 2 muaj e 1 ditë nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet e 9 muaj e 3 ditë nga dita e parashkrimit.

9) Procedimi penal nr. 270, datë 10.04.2017 i regjistruar për veprën penale **"Vjedhja"** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 29.07.2024, miratuar me vendimin nr. 632 date 04.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se në datën 10.04.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi përpara veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale ka ndodhur në datën 6.4.2017. Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 6.4.2017, deri në datën 6.4.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 17.08.2017 deri në datën 26.09.2017(vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 10.4.2022 (sipas kërkesës për pushim), pasi edhe për afatin e mbetur prej 3 vjet 3 muaj e 9 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 3 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

10) Procedimi penal nr. 442 datë 19.06.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 20.05.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 480 date 23.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datën 19.06.2022 është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe referuar vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të pasoja e ardhur nuk është një pasojë e rëndë.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 19.6.2017 deri në datën 19.6.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 19.06.2017 deri në datën 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 19.6.2022 pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 4 muaj e 26 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 11 muaj e 1 ditë nga dita e parashkrimit.

11) Procedimi penal nr. 457, datë 27.06.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 132 datë 11.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për shkak të parashkrimit, pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të veprës penale kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

*Nga rrethanat e ngjarjes së referuar rezulton se vepra penale është kryer në datën 22.6.2017. Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 22.6.2017, deri në datën 22.6.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Gentian Habazaj nga data 27.06.2017 deri në datën 26.09.2017 (vendim për zëvendësim prokurori); Andi Pogaçe nga

data 26.09.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 22.6.2022, ku prokurori dhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 5 muaj nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 6 muaj e 5 ditë nga dita e parashkrimit.

**12) Procedimi penal nr. 544 datë 03.08.2017 i regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 106 date 25.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 1.8.2017 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.**

Rezultoi se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 1.8.2017, deri në datën 1.8.2022 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 03.08.2017 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë ku për të gjithë afatin 5 vjeçar të parashkrimit deri në datën 1.8.2022 nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 4 muaj e 9 ditë nga dita e parashkrimit.

**13) Procedimi penal nr. 689, datë 13.09.2017 i regjistruar për veprën penale “Mashtrimi” të parashikuar nga neni 143 te K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 17.12.2024, miratuar me vendimin nr. 109 date 25.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se vepra penale është kryer në datën 8.9.2017 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.**

Vepra penale e mashtrimit, parashikuar nga neni 143/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me burgim deri në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezultoi se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 8.9.2017 deri në datën 8.9.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 13.09.2017 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori) ; Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë

të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 8.9.2022, ku prokurori edhe për afatin e mbetur prej 10 muaj e 27 ditë nuk ka marrë ndonjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 05.10.2023 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 3 muaj e 9 ditë nga dita e parashkrimit.

**14) Procedimi penal nr. 739 datë 22.09.2017 i regjistruar për veprën penale “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 27.05.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 422, date 05.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak në datën 22.09.2022 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale.**

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 21.09.2017. Vepra penale e parashikuar nga neni 130/a i K. Penal është krim dhe në kohën e kryerjes së saj dispozita në të katër paragrafët e saj parashikonte një dënim me burgim deri tre vjet; me burgim deri në katër vjet; me burgim deri në pesë vjet; me burgim nga një deri në pesë vjet. Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.09.2017 deri në datën 21.9.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 22.09.2017 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 22.9.2022 (sipas kërkesës për pushim), pasi për 5 vjet nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Albjona Papajani nga data 13.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 7 muaj e 5 ditë nga dita e parashkrimit.

**15) Procedimi penal nr. 748, datë 26.09.2017 i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 14.11.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 74, datë 13.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 24.9.2017 dhe rezulton i plotësuar afati pesë vjeçar i parashkrimit.**

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale datë 24.9.2017 deri në datën 24.9.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 26.09.2017 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 24.9.2022, pasi për 5 vjet nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Çulli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 1 muaj e 22 ditë nga dita e parashkrimit.

**16) Procedimi penal nr. 925, datë 14.11.2017 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 30.07.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 149, date 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se në datën 14.11.2022 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi përpara veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.**

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 8.11.2017. Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 14.11.2017, deri në datën 14.11.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 03.01.2018 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 14.11.2022 (sipas kërkesës për pushim), ku prokurori edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 9 muaj e 21 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimet me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 8 muaj e 16 ditë nga dita e parashkrimit.

**17) Procedimi penal nr. 984, datë 01.12.2017 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 143, date 18.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se në datën 01.12.2022 është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi përpara veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.**

*Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 29.11.2017. Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 1.12.2017 deri në datën 1.12.2022 nuk është*

marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkuar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 01.12.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 1.12.2022 (sipas kërkesës për pushim) pasi edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 10 muaj 8 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 13.05.2024 e në vazhdim e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 8 muaj nga dita e parashkrimit.

**18)** Procedimi penal nr. 1037, datë 18.12.2017 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashkuar nga neni 134 të K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 16.04.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 394 datë 25.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, pasi nga data e kryerjes së veprës penale 16.12.2017 ka kaluar afati i parashkrimit prej 5 vitesh duke u parashkuar që në datën 16.12.2022. Referuar vendimit unifikues vepra penale nuk është me pasojë të rëndë.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 16.12.2017 deri në datën 16.12.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkuar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 18.12.2017 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 23.01.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 16.12.2022, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 2 muaj e 5 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 3 muaj 26 ditë.

**19)** Procedimi penal nr. 1061, datë 24.12.2017i regjistruar për veprën penale **“Plagosja e lehtë me dashje”** të parashkuar nga neni 89 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me vendimin e prokurorit të datës 17.05.2024 për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit të veprës penale 3 vjet në datën 28.11.2020.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 28.11.2017 deri në datën 28.11.2020 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkuar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 06.12.2017 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 28.11.2020, pasi për 3 vjet nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 3 vjet 5 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

**20)** Procedimi penal nr. 26, datë 08.01.2018 regjistruar për veprën penale të “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024, miratuar me vendimin nr. 178 date 14.04.2025 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se ndodhemi para faktit të parashkrimit të ndjekjes penale pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të veprës penale në datën 8.1.2018 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurori Dritan Gripshi nga data 08.01.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë, gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 8.1.2023 pasi prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 vit 11 muaj e 19 ditë nga dita e parashkrimit.

**21)** Procedimi penal nr. 18, datë 14.01.2018 i regjistruar për veprën penale të “**Mashtrimi**” të parashikuar nga neni 143/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 117, datë 27.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datë 13.10.2022 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale nga data kur është kryer vepra penale 13.10.2017.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 13.10.2017 deri në datën 13.10.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkuar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 16.10.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 13.10.2022, pasi në afatin e mbetur prej 1 vit e 2 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e

cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 1 muaj e 27 ditë nga dita e parashkrimit.

22) Procedimi penal nr. 37 datë 15.01.2018 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 e 22 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 15.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 39, date 29.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak nga dita e kryerjes se veprës në datën 12.1.2018 rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 12.1.2018 deri në datën 12.1.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Andi Pogaçe nga data 15.01.2018 deri në datën 23.01.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 23.01.2018 deri në datë 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 12.1.2023, pasi prokurori në afatin e mbetur prej 4 vjet e 11 muaj e 19 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 11 muaj e 3 ditë nga dita e parashkrimit.

23) Procedimi penal nr. 187, datë 21.03.2018 i regjistruar për veprën penale "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024, miratuar me vendimin nr. 625 date 25.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me arsyetimin se në datën 21.03.2023 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.

Nuk ka rezultuar që vepra ka sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 21.3.2018 deri në datën 21.3.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ermir Beta nga data 19.03.2018 deri në datën 17.04.2018; Artan Hazbi nga data 17.04.2018 deri në datën 20.09.2018 (vendim

për zëvendësim prokurori); Dritan Gripshi nga data 20.09.2018 deri në datën 02.05.2024, periudhë, gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 21.3.2023, pasi prokurori edhe për afatin e mbetur prej 4 vjet e 5 muaj e 21 ditë nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 4 muaj e 10 ditë nga dita e parashkrimit.

**24) Procedimi penal nr. 282 datë 23.04.2018 i regjistruar për veprën penale “Pushtimi i tokës” të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, pa autor, pushuar me vendimin e datës 14.11.2024 të prokurorit, me arsyetimin se vepra penale është amnistuar dhe vepra penale është kryer në datën 18.4.2018 dhe rezulton i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.**

Vepra penale e pushtimit të tokës e parashikuar nga neni 200 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila parashikon një dënim me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 18.4.2018 deri në datën 18.4.2021 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 23.04.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 18.4.2021 pasi prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 3 vjet e 6 muaj e 26 ditë nga dita e parashkrimit.

**25) Procedimi penal nr. 328 datë 04.05.2018 i regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 30.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 101 date 24.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 30.4.2018 dhe rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.**

Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 30.4.2018 deri në datën 30.4.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 02.05.2018 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 30.04.2023, pasi edhe për afatin



e mbetur prej 1 vit e 6 muaj e 19 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 05.10.2023 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 8 muaj nga dita e parashkrimit.

26) Procedimi penal nr. 365, datë 14.05.2018 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 14.11.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 25, date 21.01.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 10.5.2018 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezultoi se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 10.5.2018 deri në datën 10.5.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 14.05.2018 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 10.5.2023, ku prokurori për 5 vjet nuk ka marrë asnjë person të pandehur ose të përfundonte hetimin me vendimmarrje për shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit e 6 muaj e 4 ditë nga dita e parashkrimit.

27) Procedimi penal nr. 443, datë 13.06.2018 i regjistruar për veprën penale “**Shkatërrimi i pronës**” të parashikuar nga neni 150 te K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 30.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 188, date 17.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 24.5.2018 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Rezultoi se nga data e kryerjes së veprës penale 24.05.2018 deri në datën 24.5.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 28.05.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 24.5.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 7 muaj e 13 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data



12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 7 muaj e 6 ditë nga dita e parashkrimit.

**28)** Procedimi penal nr. 450, datë 13.06.2018 i regjistruar për veprën penale “**Kallëzimi i rremë**” të parashikuar nga neni 305 të K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 157, datë 25.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është konstatuar në datën 26.5.2018 dhe ndodhemi para faktit të parashkrimit të ndjekjes penale pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të veprës penale kallëzimi i rremë kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Vepra penale e parashikuar nga neni 305 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 26.5.2018 deri në datën 26.5.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 28.05.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 26.5.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 7 muaj e 15 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 7 muaj e 1 ditë nga dita e parashkrimit.

**29)** Procedimi penal nr. 492, datë 26.06.2018 i regjistruar për veprën penale “**Mashtrimi**” të parashikuar nga neni 143/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 180 date 15.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se fakti është konstatuar në datën 11.2.2018. Ndjekja penale është parashkruar pasi nga koha kryerjes/konstatimit të veprës penale të mashtrimit parashikuar nga neni 143/1 i K. Penal kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur.

Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 11.2.2018 deri në datën 11.2.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 19.06.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga

data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 11.2.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 4 muaj nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 10 muaj 16 ditë nga dita e parashkrimit.

**30) Procedimi penal nr. 597 datë 24.07.2018 i regjistruar për veprën penale “Organizmi ose ushtrimi i veprimtarive të lojrave të fatit në kundërshtim me ligjin” të parashikuar nga neni 197/1 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 186 date 17.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me arsyetimin se fakti penal është konstatuar në datën 10.7.2018. Ndodhemi para faktit të parashkrimit të ndjekjes penale pasi nga koha e kryerjes/konstatimit të faktit penal kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.**

Vepra penale e parashikuar nga neni 197/1 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me burgim nga një deri në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 10.7.2018 deri në datën 10.7.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 12.07.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 10.7.2023 pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit e 8 muaj e 29 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 05.10.2023 e në vazhdim e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 5 muaj e 17 ditë nga dita e parashkrimit.

**31) Procedimi penal nr. 775, datë 05.10.2018 i regjistruar për veprën penale “Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm” të parashikuar nga neni 177/1 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 48 datë 07.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se afati i parashkrimit të veprës penale është plotësuar në datën 11.9.2023 ku kanë kaluar pesë vjet nga data kur është kryer vepra penale 11.9.2018.**

Vepra penale e parashikuar nga neni 177/1 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me burgim deri në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet

se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 11.09.2018 deri në datën 11.9.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 28.09.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 11.09.2023, pasi në afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 2 muaj e 29 ditë nga data e parashkrimit.

**32)** Procedimi penal nr. 832, datë 25.10.2018 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 169 date 08.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të parashkrimit pasi nga data e konstatimit të veprës penale 5.10.2018 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person i pandehur.

Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 5.10.2018 deri në datën 5.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 08.10.2018 deri në datën 17.10.2018 (vendim për zëvendësim prokurori); Olsian Çela nga data 17.10.2018 deri në datën 22.01.2019 (vendim për zëvendësim prokurori); Olgert Rumnici nga data 22.01.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 5.10.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 vit 11 muaj e 24 ditë nga prokurori nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Malvina Pëllumbi nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 2 muaj e 22 ditë nga data e parashkrimit.

**33)** Procedimi penal nr. 828 datë 25.10.2018 i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrimi i pronës me zjarr”** të parashikuar nga neni 151/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën



e datës 25.11.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 7, date 07.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se nga koha e kryerjes se veprës penale në datën 13.10.2018 kanë kaluar 5 vjet dhe afati i parashkrimit është plotësuar në datën 13.10.2023.

Vepra penale e parashikuar nga neni 151/1 i K. Penal është krim, i cili në kohën e kryerjes parashikonte një dënim me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 13.10.2018, deri në datën 13.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 16.10.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, ku gjatë kësaj kohe është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 13.10.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 1 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit.

**34) Procedimi penal nr. 855 datë 02.11.2018 i regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 28, date 23.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datën 24.10.2023 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale nga data e kryerjes së veprës penale 24.10.2018.**

Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 24.10.2018 deri në datën 24.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 24.10.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, ku në këtë periudhë është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 24.10.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 19 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e saj, pas 1 vit 1 muaj e 16 ditë nga dita e parashkrimit.

**35) Procedimi penal nr. 862, datë 05.11.2018 i regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” të parashikuar nga neni 150 te K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës**



10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 156 date 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datën 27.10.2023 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale nga data e kryerjes së veprës penale 27.10.2018.

Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 27.10.2018 deri në datën 27.10.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 31.10.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, ku gjatë kësaj kohe është plotësuar afati i parashkrimit në datën 27.10.2023, pasi edhe për afatin e mbetur prej 15 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak parashkrimi.

**36) Procedimin penal nr. 889, datë 13.11.2018 i regjistruar për veprën penale “Braktisja e fëmijëve të mitur” të parashikuar nga neni 124/1 i K.Penal, pa autor, pushuar me kërkesën e datës 17.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 36 date 27.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se nga kryerja e veprës penale në datën 3.9.2018 ka kaluar afati prej 5 vjet dhe afati i parashkrimit është plotësuar në datën 3.9.2023.**

Vepra penale e parashikuar nga neni 124/1 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 3.9.2018 deri në datën 3.9.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 04.09.2018 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 3.9.2023, pasi në afatin e mbetur prej 1 vit 10 muaj e 22 ditë, nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 1 vit 3 muaj e 14 ditë nga dita e parashkrimit.

**37)** Procedimi penal nr. 62, datë 31.01.2019 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, (procedimi penal është pezulluar dhe me vendimin e datës 25.11.2021 është vendosur rifillimi i hetimeve) është pushuar me kërkesën e datës 17.07.2024, miratuar me vendimin nr. 232, date 30.05.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se në datën 31.01.2024 është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal është krim, i cili parashikon në tre paragrafët e tij përkatësisht dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet; me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së veprës penale 31.01.2019 deri në datën 31.01.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurori Tasim Puci nga data 23.01.2019 deri në datën 01.11.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data e rifillimit të hetimeve 25.11.2021 deri në datën 12.10.2023; Denisa Perdja nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 31.1.2024 pasi në afatin e mbetur prej 3 muaj e 19 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 9 muaj e 5 ditë nga dita e parashkrimit.

**38)** Procedimi penal nr. 187 datë 14.03.2019 i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrimi i pronës”** të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 14.11.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 154 date 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se nga koha e ndodhjes së faktit penal datë 2.3.2019 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe rezulton se është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 2.3.2019 deri në datën 2.3.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 05.03.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja

nga data 12.10.2023 deri ne datën 04.09.2024, periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 2.3.2024, pasi për afatin e mbetur prej 8 muaj nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 8 muaj e 12 ditë nga dita e parashkrimit.

**39)** Procedimi penal nr. 234 datë 08.04.2019 i regjistruar për veprën penale **“Falsifikimi i dokumenteve”** të parashikuar nga neni 186 i K.Penal, **pa autor**, është kërkuar pushimi me kërkesën e datës 16.12.2024 të prokurorit, për shkak se vepra penale është kryer në datën 26.3.2019 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Procedimi penal është akoma në fazën e shqyrtimit në seancë paraprake.

**40)** Procedimi penal nr. 372 datë 28.05.2019 i regjistruar për veprën penale **“Dhuna në familje”** të parashikuar nga neni 130/a/2 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 04.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 150, datë 20.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale në datën 9.5.2024 nga data kur është kryer vepra penale në datë 9.5.2019.

Vepra penale e parashikuar nga neni 130/a-2 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me burgim deri në katër vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezultoi se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 09.05.2019 deri në datën 09.05.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashikuar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 13.05.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 9.5.2024, pasi për afatin e mbetur prej 6 muaj e 27 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 6 muaj e 25 ditë nga dita e parashkrimit.

**41)** Procedimi penal nr. 390, datë 31.05.2019 i regjistruar për veprën penale **“Shkatërrimi i pronës me zjarr”** të parashikuar nga neni 151/I i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 30.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 69, datë 12.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se vepra penale është kryer në datën 31.05.2019 dhe rezultoi i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

*Nga rrethanat e ngjarjes rezulton se vepra është kryer në datën 23.5.2019. Rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 23.5.2019 deri në datën 23.5.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 30.05.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Eni Culli nga data 12.10.2023 e në vazhdim, ku gjatë kësaj kohe është plotësuar afati i parashkrimit në datën 31.5.2024 (sipas kërkesës për pushim), pasi në afatin e mbetur prej 7 muaj e 19 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 6 muaj e 29 ditë nga dita e parashkrimit.

**42)** Procedimi penal nr. 403, datë 31.05.2019 i regjistruar për veprën penale **“Vjedhja”** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 31.07.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 176 datë 14.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se në datën 31.05.2024 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale. Referuar vendimit unifikues nuk ndodhemi para veprës penale të vjedhjes me pasoja të rënda.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së veprës penale 31.05.2019 deri në datën 31.05.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 30.05.2019 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim ku në këtë periudhë është plotësuar afati i parashkrimit në datën 31.5.2024, pasi në afatin e mbetur prej 29 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 2 muajve nga dita e parashkrimit.

**43)** Procedimi penal nr. 443 datë 17.06.2019 i regjistruar për veprën penale **“Pushtimi i tokës”** të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me vendimin e datës 30.07.2024 të prokurorit, me arsyetimin se afati i parashkrimit 3 vjet është plotësuar në datën 17.6.2022, si dhe se vepra penale është amnistuar.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 17.6.2019 deri në datën 17.6.2022 kanë kaluar tre vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.



Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 17.06.2019 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori) periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 17.6.2022, ku prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë të pandehur ose të përfundonte hetimet me një vendimmarrje për shkak tjetër ligjor; Aida Yzeiraj nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 1 muaj 13 ditë nga dita e parashkrimit.

**44)** Procedimi penal nr. 500, datë 05.07.2019 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 4.12.2024, miratuar me vendimin nr. 61, datë 10.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është amnistuar dhe nga data e kryerjes së veprës penale 12.6.2019 është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 12.06.2019 deri në datën 12.06.2024 kanë kaluar pesë vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 14.06.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes pasi është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 12.06.2024, pasi në afatin e mbetur prej 8 muaj nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor.

**45)** Procedimi penal nr. 515, datë 08.07.2019 i regjistruar për veprën penale “**Pushtimi i tokës**” të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me vendimin e datës 31.07.2024 të prokurorit, me arsyetimin se afati i parashkrimit është 3 vjet që rezulton të jetë plotësuar në datën 08.07.2022.

Në referim të nenit 66, shkronja d) të K. Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 8.7.2019, deri në datën 8.7.2022 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurori Dritan Gripshi nga data 08.07.2019 deri në datë 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 8.7.2022, pasi prokurori për 3 vjet nuk ka marrë asnjë person si të pandehur ose të përfundonte hetimet me vendimmarrje për një shkak

tjetër ligjor; Denisa Perdja nga data 02.05.2024 e në vazhdim, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet e 23 ditë nga dita e parashkrimit.

46) Procedimi penal nr. 550, datë 23.07.2019 i regjistruar për veprën penale “**Ndërtimi i paligjshëm**” të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 10.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 49, date 07.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 12.7.2019 dhe kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Vepra penale e parashikuar nga neni 199/a-1 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me burgim deri në një vit dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 12.07.2019 deri në datën 12.07.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 15.07.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 12.7.2024, pasi dhe për afatin e mbetur në dispozicion prej 9 muaj nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit.

47) Procedimi penal nr. 624 datë 02.09.2019 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 14.11.2024 të prokurorit, me arsyetimin se është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale pasi vepra penale është kryer në datën 16.8.2019.

Vepra penale e parashikuar nga neni 134 i K. Penal është krim, i cili parashikon në tre paragrafët e tij përkatësisht dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet; me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 16.08.2019 deri në datën 16.08.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 21.08.2019 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Eni Culli nga data



02.05.2024 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit në datën 16.08.2024, pasi për afatin e mbetur prej 3 muaj e 14 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 muaj e 28 ditë nga dita e parashkrimit.

**48) Procedimi penal nr. 736, datë 20.09.2019 i regjistruar për veprën penale “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” të parashikuar nga neni 293 i K.Penal, pa autor,** pushuar me kërkesën e datës 26.11.2024 të prokurorit, me arsyetimin se referuar kohës së kryerjes së veprës penale është plotësuar afati 5 vjet i parashkrimit të ndjekjes penale.

*Nga rrethanat e ngjarjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 17.9.2019. Vepra penale e parashikuar nga neni 293 i K. Penal është krim, i cili parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 17.09.2019 deri në datën 17.09.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.*

Për hetimet e këtij procedimi penal nuk ka informacion për prokurorët që kanë ndjekur hetimin paraprak.

**49) Procedimi penal nr. 799, 14.10.2019 i regjistruar për veprën penale “Pushtimi i tokës” të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, pa autor,** pushuar me vendimin e datës 14.11.2024 të prokurorit, me arsyetimin se vepra penale është amnistuar dhe vepra është kryer në datën 20.12.2018 dhe rezulton i plotësuar afati tre vjeçar i parashkrimit.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 20.12.2018 deri në datën 20.12.2021 kanë kaluar tre vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 21.12.2019 deri në datën 02.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori), periudhë gjatë të cilës është plotësuar afati i parashkrimit në datën 20.12.2021 pasi për 3 vjet nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor; Eni Culli nga data 02.05.2024 e në vazhdim, i cili ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 vjet 10 muaj e 24 ditë nga dita e parashkrimit.

**50) Procedimi penal nr. 901, datë 25.11.2019 i regjistruar për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, pa autor,** pushuar me kërkesën e datës 27.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 88, date

17.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak se referuar kohës së kryerjes së veprës penale në datën 24.10.2019 ka kaluar afati 5 vjeçar i ndjekjes penale.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 24.10.2019 deri në datën 24.10.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 25.10.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 05.10.2023 deri në datë 04.09.2024; Arjeta Plaku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, ku gjatë kësaj periudhe është plotësuar afati i parashkrimit në datën 24.10.2024, pasi për afatin e mbetur prej 1 muaj e 20 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit pas 2 muaj e 3 ditë nga dita e parashkrimit.

**51)** Procedimi penal nr. 902, datë 25.11.2019 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 11.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 23, date 21.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale në datën 26.10.2024, nga data kur është kryer vepra penale, 26.10.2019.

Në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 26.10.2019 deri në datën 26.10.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 28.10.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 26.10.2024, pasi për afatin e mbetur prej 1 vit e 14 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit, pas 1 muaj e 15 ditë nga dita e parashkrimit.

**52)** Procedimi penal nr. 977, datë 05.12.2019 i regjistruar për veprën penale “**Vjedhja**” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 11.12.2024 të

prokurorit, miratuar me vendimin nr. 24, datë 21.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se në datën 03.12.2024 është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale nga data kur është kryer vepra penale 3.12.2019.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 3.12.2019 deri në datën 3.12.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 05.12.2019 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datën 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 3.12.2024, pasi për afatin e mbetur 1 vit e 1 muaj e 21 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit.

**53)** Procedimi penal nr. 959, datë 20.12.2019 i regjistruar për veprën penale **"Vjedhja"** të parashikuar nga neni 134 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me kërkesën e datës 15.12.2024 të prokurorit, miratuar me vendimin nr. 51 datë 10.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me arsyetimin se vepra penale është kryer në datën 10.12.2019 dhe rezulton i plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Nuk ka rezultuar që vepra të ketë sjellë pasoja të rënda sipas paragrafit të tretë, kështu që në referim të nenit 66 shkronja ç) të K. Penal, ku përcaktohet se për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet, rezulton se sipas paragrafit të parë apo edhe të dytë, nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 10.12.2019 deri në datën 10.12.2024 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Dritan Gripshi nga data 11.12.2019 deri në datën 13.05.2024 (vendim për zëvendësim prokurori); Eni Culli nga data 13.05.2024 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati i parashkrimit në datën 10.12.2024, pasi për afatin e mbetur prej 6 muaj e 27 ditë nuk është marrë asnjë person si i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit.

**54)** Procedimi penal nr. 444, datë 21.07.2021 i regjistruar për veprën penale **"Vetëgjyqësia"** të parashikuar nga neni 277 i K.Penal, **pa autor**, pushuar me vendimin e datës 05.08.2024 me arsyetimin se vepra penale është amnistuar dhe rezulton të jetë plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale 3 vjet në datën 4.8.2023.



Nga rrethanat e çështjes rezulton se vepra penale është kryer në datën 21.7.2020. Vepra penale e vetëgjyqësisë e parashikuar nga neni 277 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila parashikon një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K.Penal ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet, rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale 21.07.2023 deri në datën 21.07.2023 nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 11.08.2020 deri në datë 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri kur është zëvendësuar nga prokurore Denisa Perdja, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për amnisti.

55) Procedimi penal nr. 448, datë 21.07.2021i regjistruar për veprën penale **“Punësimi i paligjshëm”** të parashikuar nga neni 170/a/1 të K.Penal, **pa autor**, pushuar me vendimin e datës 10.12.2024 të prokurorit, me arsyetimin se vepra penale është amnistuar dhe “ndjekja penale është parashkruar pasi ka kaluar afati tre vjeçar nga momenti i kryerjes së veprës penale në datën 23.2.2021, afat i cili është plotësuar në datën 23.2.2024.

Vepra penale e punësimit të paligjshëm parashikuar nga neni 170/a-1 i K. Penal përbën kundërvajtje penale, e cila parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 vit dhe në referim të nenit 66, shkronja d) të K.Penal, ku përcaktohet se për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim afati i parashkrimit është tre vjet rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre 23.2.2021 deri në datën 23.2.2024 nuk është marrë asnjë person i pandehur dhe si rrjedhim ndjekja penale për këtë vepër penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Për hetimet e këtij procedimi penal nuk ka informacion për prokurorët që kanë djekur hetimin paraprak.

56) Procedimi penal nr. 468, datë 21.07.2021 i regjistruar për veprën penale **“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregull”** të parashikuar nga neni 291 te K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 25.10.2024, miratuar me vendimin nr. 677 date 04.12.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, pasi nga koha e ndodhjes së faktit penal në datën 5.9.2019 kanë kaluar mbi 5 vjet dhe ndjekja penale është parashkruar.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj vepre penale 5.9.2019 deri në datën 5.9.2024 kanë kaluar 5 vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.



Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 06.09.2021 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Adnan Hoxha nga data 11.10.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Denisa Perdja nga data 05.10.2023 deri në datën 04.09.2024; Renato Tosku nga data 04.09.2024 e në vazhdim, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes pasi në këtë kohë është plotësuar afati i parashkrimit në datën 5.9.2024, duke pasur në dispozicion 1 ditë për të marrë të pandehur ose për të përfunduar hetimet me vendimmarrje tjetër.

57) Procedimi penal nr. 435, datë 21.07.2021 i regjistruar për veprën penale **“Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve, mallrave industrial dhe ushqimorë”** të parashikuar nga neni 288/a i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 26.11.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 288/a/1 të K.Penal, pasi vepra penale është amnistuar dhe ndjekja penale për veprën penale të parashikuar si kundërvajtje është parashkruar pasi ka kaluar afati tre vjeçar nga momenti i kryerjes së veprës penale në datën 29.10.2020 i cili është plotësuar në datën 29.10.2023.

Rezulton se nga data e kryerjes së kësaj kundërvajtje penale 29.10.2020, deri në datën 29.10.2023 kanë kaluar tre vjet dhe nuk është marrë asnjë person si i pandehur e si rrjedhim ndjekja penale është parashkruar gjatë hetimit paraprak.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Olgert Rumnici nga data 30.10.2020 deri në datën 11.10.2021 (vendim për zëvendësim prokurori); Elidon Hysenaj nga data 11.10.2021 deri në datë 12.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 12.10.2023 e në vazhdim, periudhë në të cilën është plotësuar afati 3 vjeçar i parashkrimit në datën 29.10.2023, pasi dhe për afatin e mbetur prej 17 ditë nuk është marrë asnjë person i pandehur ose të përfundohej hetimi me vendimmarrje për një shkak tjetër ligjor, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të amnistisë dhe parashkrimit të ndjekjes penale pas 1 vit e 27 ditë nga dita e parashkrimit.

58) Procedimi penal nr. 618, datë 07.10.2021 i regjistruar për veprën penale **“Ndërtim i paligjshëm”** të parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, **pa autor**, është pushuar me kërkesën e prokurorit të datës 25.06.2024, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal pasi vepra penale është amnistuar dhe nga koha e kryerjes së veprës penale datë 24.3.2021 kanë kaluar tre vjet dhe ndjekja penale është parashkruar, miratuar me vendimin nr. 537 datë 30.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, pasi ka konstatuar se vepra penale është amnistuar.

Hetimet e këtij procedimi penal janë ndjekur nga prokurorët Ledion Tema nga data 25.03.2021 deri në datën 05.10.2023 (vendim për zëvendësim prokurori); Aida Yzeiraj nga data 05.10.2023 e në vazhdim, e cila ka kërkuar pushimin e çështjes për amnisti, **ndërsa**



*vepra penale nuk ishte parashkruar*, ku në këtë rast prokurori i është referuar gabim ligjit material për afatin 3 vjet të parashkrimit, pasi vepra penale është krim, i cili në kohën e kryerjes dënohej me burgim deri në një vit dhe bazuar në nenin 66 shkronja ç) të K. Penal, për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë afati i parashkrimit është 5 vjet.

## **II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore**

Objekti i këtij inspektimi ishin çështjet e pushuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë hetimeve paraprake në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Berat, me përjashtim të dosjeve të pezulluara dhe të rifilluara me qëllim pushimin e tyre për shkak të plotësimit të afateve të parashkrimit, si dhe në ato raste kur afati i parashkrimit të ndjekjes penale është konstatuar gjatë hetimeve se ishte plotësuar që para regjistrimit të procedimit penal.

Në kreun V: "Veprimtaria e prokurorit" dhe konkretisht në nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar qartë se: "1. Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. ....2. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, ...."

Prokurori është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë hetimore, përcaktimin e detyrave të oficerëve të policisë gjyqësore dhe ndjekjen e zbatimit të tyre deri në përfundimin dhe zgjidhjen ligjore të procedimit brenda afateve ligjore. Afatet procedurale hetimore janë periudha kohore të caktuara në ligj, brenda të cilave, prokurori ka detyrimin të kryejnë detyrat e tij, të cilat kanë për qëllim disiplinimin e punës dhe veprimtarisë procedurale në funksion të zgjidhjes së drejtë të procedimit penal, zbulimit të së vërtetës dhe vënies përpara përgjegjësisë penale të autoreve të veprës penale.

Kodi i Procedurës Penale përcakton një sërë parashikimesh procedurale në lidhje me afatet e ndjekjes penale ndaj personit konkret dhe të parashkrimit të ndjekjes penale. Në kreun VII "Afatet e përfundimit të hetimeve", në nenin 323, pika 1 parashikohet afati i hetimeve paraprake, "Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj", ndërsa në nenin 324, pika 1 dhe 2, parashikohet zgjatja e afatit të hetimeve deri në tre muaj dhe zgjatje të mëtejshme me periudha deri tre mujore në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur deri në 2 vjet.

Ndërsa, dispozita e nenit 66 të Kodit Penal bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale me të cilin kuptohet ndalimi që ekziston me ligj për të bërë ndjekje penale, në qofte se, nga koha kur është kryer vepra penale, deri në momentin e marrjes si të pandehur të autorit të dyshuar të saj, kanë kaluar afatet e parashikuara në këtë dispozitë<sup>11</sup>. Pra, ndjekja penale ndaj një personi për një vepër penale të kryer nuk mund të ushtrohet pas kalimit të një kohe të caktuar dhe për këtë arsye ka rëndësi të bëhet cilësimi i drejtë i faktit penal.

Instituti i parashkrimit të ndjekjes penale nënkupton pamundësinë e organeve të ndjekjes penale për të kryer hetime dhe për të vendosur përpara përgjegjësisë penale çdo person, i cili dyshohet për kryerjen e një vepre penale, nëse vërtetohet fakti juridik me karakter shues i kalimit të afatit kohor nga momenti i kryerjes së veprës penale deri në momentin e marrjes të pandehur të këtij personi<sup>12</sup>. Gjithashtu, parashkrimi ka si qëllim të krijojë siguri juridike dhe të parandalojë që ndjekja penale ndaj individëve të jetë e pakufizuar në kohë. Zhvillimi i ndjekjes penale në një kohë kur ajo është shuar për shkak të parashkrimit e bën procesin të parregullt dhe objekt të kontrollit kushtetues. Ky institut nuk nënkupton pasivitetin e organit të ndjekjes penale për zbardhjen e ngjarjes dhe të autorëve të saj<sup>13</sup>.

Nga analiza e fakteve dhe akteve të administruara rezulton se kalimi i afateve të parashkrimit të ndjekjes penale në dosjet e shqyrtuara në prokuroritë Lezhë dhe Berat ka ardhur për shkak të zvarritjes dhe moskryerjes së hetimeve për periudha kohore të gjata, deri në përfundimin e afateve hetimore ndaj personave të cilëve ju atribuohet vepra penale dhe afateve tërësore të ushtrimit të ndjekjes penale me pasojë shuarjen e ndjekjes penale dhe pushimin e çështjeve për veprat penale përkatëse. Në dy raste ka rezultuar se janë kryer veprime hetimore derisa ka rezultuar që afati i parashkrimit ishte plotësuar që para regjistrimit të procedimit penal. Dosjet e parashkruara në Prokurorinë Berat dhe Prokurorinë Lezhë kanë të bëjnë me procedime penale të regjistruara në vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Hetimet e kryera për këto procedime përfshijnë edhe periudhën e pandemisë të vitit 2020, kur veprimet e organit të akuzës kanë qenë të kufizuara, por duke marrë në konsideratë llojin e procedimeve, të cilat nuk kanë qenë komplekse dhe kryesisht për afate 5 vjeçare të parashkrimit të ndjekjes penale, kjo periudhë nuk ka cënuar marrjen e personave si të pandehur ose përfundimin e çështjeve për çdo shkak tjetër ligjor. Në analizat vjetore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat pasqyrohet ngarkesa e prokurorëve që kanë trajtuar këto procedime dhe organika efektive e kësaj prokurorie për vitet në të cilat ka zgjatur hetimi i këtyre procedimeve penale 2017-2023.

<sup>11</sup> Vendimi unifikues nr. 7, datë 11.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

<sup>12</sup> Vendim nr. 00-2023-1038(123), datë 18.04.2023 i Kolegjit Penal

<sup>13</sup> Vendim i gjykatës kushtetuese nr.28, datë 20.6.2007

Me hetimin e çështjeve të parashkuara kanë qenë të ngarkuar disa prokurorë me periudha të ndryshme, të cilët thjesht kanë zëvendësuar njëri-tjetrin për shkak të largimeve ose transferimeve, pasi që pas regjistrimit të procedimit penal rezulton se janë kryer disa veprime hetimore deri në një moment të caktuar ose nuk është kryer asnjë veprim hetimor, për periudha që variojnë nga 1 deri në 7 vite. Edhe në ndonjë rast ku ka akte të njoftimit të akuzës, si në Prokurorinë Berat, ato janë të panjoftuara ndonjë personi që të merrte cilësinë e të pandehurit, duke mos sjellë asnjë efekt në ecjen e afatit të parashkrimit. Prokurorët që kanë paraqitur kërkesat për pushim në gjykatë ose kanë vendosur pushimin apo dhe prokurorë të tjerë para tyre kanë marrë dosje tashmë të parashkuara të pavëna në lëvizje prej kohësh.

### III. Gjetjet e inspektimit

Nga inspektimi tematik rezultoi se gjatë vitit 2024 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë hetimeve paraprake 2 çështje penale, ndërsa një çështje rezultoi të ishte jashtë objektit të inspektimit pasi parashkrimi ishte plotësuar që para regjistrimit të procedimit penal. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat janë pushuar 123 çështje penale, ndërsa një çështje rezultoi të ishte jashtë objektit të inspektimit pasi parashkrimi i ndjekjes penale ishte plotësuar që para se të regjistrohej procedimi penal.

Referuar analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim rezulton se numrin më të madh të veprave penale të trajtuara në lidhje me pushimet e procedimeve penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale i përkasin veprave penale si më poshtë:

- "Vjedhja" parashikuar nga neni 134 i K. Penal me 43 procedime penale;
- "Ndërtimi i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i K. Penal me 13 procedime penale;
- "Shkatërrimi i pronës" parashikuar nga neni 150 i K. Penal me 9 procedime penale;
- "Plagosja e lehtë me dashje" parashikuar nga neni 89 i K. Penal me 6 procedime penale;
- "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia" parashikuar nga neni 161 i K. Penal me 5 procedime penale;
- "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a i K. Penal me 5 procedime penale;
- "Braktisja e fëmijëve të mitur" parashikuar nga neni 124 i K. Penal me 4 procedime penale;
- "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 i K. Penal me 4 procedime penale;
- "Pushtimi i tokës" parashikuar nga neni 200 i K. Penal me 4 procedime penale;
- "Shkatërrimi i pronës me zjarr" parashikuar nga neni 151 i K. Penal me 3 procedime

penale;

- "Mashtrimi" parashikuar nga neni 143/1 i K. Penal me 3 procedime penale;
- "Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore" të parashikuar nga neni 288/a i K. Penal me 3 procedime penale;
- "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290/2 i K. Penal me 2 procedime penale;
- "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" parashikuar nga neni i 279 i K. Penal me 2 procedime penale;

Si dhe vepra penale të tjera të trajtuara me nga një procedim penal, siç janë ato të parashikuara nga neni 85 i K. Penal, neni 91 i K. Penal, neni 96 i K. Penal, neni 146 i K. Penal, neni 152 i K. Penal, neni 159 i K. Penal, neni 186 i K. Penal, neni 170/a i K. Penal, neni 177 i K. Penal, neni 178 i K. Penal, neni 179 i K. Penal, neni 180 i K. Penal, neni 181 të K. Penal, neni 189 i K. Penal, neni 197 i K. Penal, neni 236 të K. Penal, neni 277 i K. Penal, neni 278 i K. Penal, neni 293 i K. Penal dhe neni 305 i K. Penal.

Nga çështjet penale të cilat janë parashkruar në lidhje me vepra të ndryshme penale rezulton se 23 vepra penale janë kundërvajtje penale të parashkruara në afatin 3 vjeçar të parashkrimit dhe 105 vepra penale janë krime të parashkruara në afatin 5 vjeçar të parashkrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ndërsa 2 vepra penale janë krime të parashkruara në afatin 5 vjet të parashkrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

Nga çështjet e parashkruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat rezulton që 78 çështje të jenë dosje pa autor dhe 46 çështje rezultojnë të jenë dosje me autor (person të cilit i atribuohet vepra penale) nga të cilët 36 persona për krime, 3 prej tyre me masa sigurimi "detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore" dhe 15 persona për kundërvajtje penale, 8 prej tyre me masa sigurimi "detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore", ndërsa dy çështjet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë dosje pa autor.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në një rast është konstatuar se nga prokurori nuk është aplikuar drejt instituti i parashkrimit duke i llogaritur afatet si krim dhe duke mbajtur dosjen në hetim, ndërkohë që vepra penale ishte kundërvajtje dhe ndjekja penale për të ishte parashkruar vite më parë. Gjithashtu në këtë Prokurori ka raste që ndonëse vepra penale ishte parashkruar më herët është kërkuar pushimi i çështjes për shkak tjetër si psh amnisti në bazë të ligjit nr.33/2024 ose fakti nuk përbën vepër penale. Në çështjet e parashkruara, edhe pse afatet e parashkrimit ishin plotësuar me kohë, gjatë periudhave që i kanë pasur në hetim prokurorë të tjerë, këto dosje kanë mbetur

pa veprim, pa i dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim ose vendosur pushimin për periudha të gjata kohore.

Nga të dhënat e dërguara rezultoi se në 2 raste për kërkesat për pushim të prokurorëve me shkak parashkrimin e ndjekjes penale, Gjykata e Shkallës së Parë Berat ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, ndërsa nuk kishte raste të ankimit ndaj vendimeve të gjykatës që ka vendosur pushimin e çështjes për parashkrim të ndjekjes penale. Nga gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka pasur 5 (pesë) vendime të formës së prerë, në të cilat është vendosur kthimi i akteve prokurorit, kur shkak i pushimit ka qenë për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale.

#### **IV. Konkluzione**

Për rastet e evidentuara në prokuroritë e inspektuara, referuar ligjit (nenit 66 të Kodit Penal) në fuqi në kohën kur ka ndodhur vepra penale, rezulton pamundësia e ushtrimit të ndjekjes penale në kushtet e shkakut ndalues të parashkrimit, shuarjes së afatit të ushtrimit të saj, për sa kohë që nga kryerja e veprës penale deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar afatet e parashikuara në nenin 66 të K. Penal. Kjo për shkak të moskryerjes së veprimeve hetimore në kohë për marrjen e provave të nevojshme për zbardhjen e ngjarjeve apo lënia pa asnjë veprim e dosjeve, derisa ndjekja penale është parashkruar dhe si pasojë autorët e mundshëm ose ata të identifikuar të veprave penale kanë mundur t'i shmangen drejtësisë. Nëse për këto çështje do të ishin kryer veprime hetimore efektive dhe në kohë nga ana e prokurorëve rezultatet e hetimeve të tyre do të ishin të ndryshme, por asnjëra prej tyre nuk do të pushohej detyrimisht për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale gjatë fazës së hetimit paraprak (duke ju parashkruar prokurorëve në dorë). Edhe në rastet e dosjeve me autorë të panjohur do të ekzistonte mundësia që këto çështje potencialisht të ktheheshin në çështje me autorë të dyshuar të veprave penale nëse pas kryerjes së veprimeve të mundshme hetimore prokurori do të pezullonte hetimet në mënyrë që gjatë kësaj faze (jo aktive të hetimit) të grumbulloheshin të dhëna të reja për rifillimin e tyre brenda afateve të parashkrimit për vazhdimin e hetimeve. Për rrjedhojë, organi i prokurorisë në këto çështje nuk ka ushtruar funksionin themelor të tij, të ushtrimit të ndjekjes penale dhe ngritjes së akuzës, nuk ka përmbushur detyrimet e tij për të ndërmarrë në kohë veprime aktive, duke sjellë në këtë mënyrë pandëshkueshmërinë e autorëve të veprave penale, çka është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut tek prokuroria.

Me konstatimin e kësaj gjendjeje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat evidentohet se nuk ka funksionuar edhe roli i drejtuesit të prokurorisë në ushtrimin e kompetencave të tij në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale, duke



kërkuar informacion për ecurinë e procedimeve apo duke verifikuar ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, dhe, në raste të nevojshme, nxjerrjen e udhëzimeve me shkrim.

## V. Rekomandimet

- Për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Lezhë, subjekte të inspektimit:
  1. Raporti i inspektimit t'i njoftohet prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me rezultatet e këtij inspektimi tematik.
    - Në funksion të garantimit të ushtrimit efektiv të ndjekjes penale, rekomandohet që prokuroritë e inspektuara të ndërmarrin masa për ngritjen dhe konsolidimin e mekanizmave të strukturuar dhe të qëndrueshëm të monitorimit të afateve të parashkrimit. Në këtë kuadër, vlerësohet e domosdoshme implementimi i praktikave të mira administrative që mundësojnë identifikimin në kohë reale të procedimeve penale që i afrohen përfundimit të afatit të parashkrimit, si dhe ndërhyrjen *proaktive* apo reagimin në kohë përmes veprimeve procedurale të nevojshme, me qëllim shmangien e pasojave që sjell shuarja e ndjekjes penale.
    - Për ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të afateve të parashkrimit, rekomandohet që brenda një afati të caktuar, prokuroritë e inspektuara të hartojnë dhe zbatojnë një mekanizëm të standardizuar për monitorimin e afateve të parashkrimit, i cili mund të përfshijë regjistra periodikë (*manualë ose elektronikë*) të çështjeve sipas afateve të parashkrimit; kategorizimin e procedimeve sipas nivelit të riskut (afat i afërt, mesatar, i largët); sinjalizim automatik ose administrativ për çështjet që hyjnë në "zonë rreziku" (p.sh. 6 muaj para parashkrimit).
    - Në kuadër të zbatimit në mënyrë sa më të drejtë të ligjit penal material dhe institutit të parashkrimit paraprakisht vlerësohet se në mbështetje të nenit 66 të Kodit Penal dhe dispozitave të pjesës së posaçme të tij që përcaktojnë natyrën e veprave penale, rekomandohet që prokurorët të sigurojnë *kualifikimin apo cilësimin e saktë juridik* të veprave penale dhe përllogaritjen e drejtë të afateve të parashkrimit. Çdo interpretim i gabuar i llojit të veprës penale (krim/kundërvajtje) ose aplikimi i pasaktë i shkaqeve të pushimit përbën shkelje të parimit të zbatimit të drejtë të ligjit dhe cenon parimin e sigurisë juridike, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta në ushtrimin e ndjekjes penale.
    - Në mbështetje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë pezullimin



e hetimeve, rekomandohet që prokurorët, në rastet kur autori i veprës penale nuk identifikohet, të aplikojnë në mënyrë të arsyetuar këtë institut procedural pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore. Ky mekanizëm përbën një instrument të rëndësishëm për garantimin e vijueshmërisë së mundshme të ndjekjes penale dhe shmangien e parashkrimit për shkak të mosveprimit nga ana e organit të prokurorisë.

- Në mbështetje të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", i cili parashikon kompetencat e drejtuesit të prokurorisë për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së prokurorëve, rekomandohet që drejtuesit të ushtrojnë në mënyrë aktive këto kompetenca. Në këtë kuadër, drejtuesi i prokurorisë ka detyrimin të kërkojë informacion mbi ecurinë e procedimeve penale, të verifikojë zbatimin e ligjit dhe, kur është e nevojshme, të japë udhëzime të detyrueshme për prokurorët, me qëllim garantimin e funksionimit efektiv të ushtrimit të ndjekjes penale.
- Rekomandohet që prokurorët të sigurojnë një ritëm të qëndrueshëm dhe të dokumentuar të veprimeve hetimore, duke planifikuar paraprakisht veprimet hetimore për çdo procedim penal, shmangur periudhat e pajustificuara të pasivitetit, si dhe dokumentuar në mënyrë të rregullt çdo veprim ose mosveprim procedural.
- Në mbështetje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë mënyrën e përfundimit të hetimeve dhe paraqitjen e kërkesave për pushim në gjykatë, rekomandohet që prokurorët të respektojnë në mënyrë rigoroze kërkesat ligjore për arsyetimin juridik të këtyre akteve. Mungesa e një arsyetimi të plotë dhe të bazuar në ligj cenon cilësinë e aktit procedural dhe sjell pasoja në efikasitetin e procesit penal, siç evidentohet edhe nga rastet e kthimit të akteve nga gjykata.
- Në këtë kuadër, për rritjen e cilësisë së akteve procedurale dhe reduktimin e kthimeve nga gjykata, rekomandohet që të vendoset një *standard minimal* për arsyetimin juridik të kërkesave për pushim, të kryhet analizë periodike e vendimeve të gjykatës që kthejnë aktet, si dhe zhvillimi i takimeve periodike mes prokurorëve për unifikimin e praktikës.
- Rekomandohet gjithashtu, që bazuar në kërkesat e nenit 42 shkronjat "d" dhe "f" të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar problematikat e evidentuara në këtë Raport inspektimi të jenë objekt diskutimi dhe trajtimi në mbledhjen e prokurorëve.

#### ➤ **Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë**



1. Referuar gjetjeve në këtë raport vlerësohet verifikimi i të dhënave lidhur me fakte që nëse provohen mund të përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, për magjistratët prokurorë, për sa i përket të gjitha procedimeve penale të përmendura në Raport për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Lezhë<sup>14</sup>, të cilat për shkak të zvarritjes së hetimeve kanë sjellë si pasojë parashkrimin e ndjekjes penale.
2. Ndjekja në vijimësi e rekomandimeve të këtij inspektimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar,

### **PROPOZOJMË:**

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 10, datë 08.03.2025 "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt "Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024" i ndryshuar.
2. Caktimin e periudhës nga data 10.04.2026 deri në datën 10.10.2026, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohen Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Lezhë, për përfundimin e inspektimit tematik, Prokurori i Përgjithshëm, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke u dërguar një kopje të Raportit të Inspektimit.

### **INSPEKTORË**

**Julian Zonja**

**Lindita Ziguri**

<sup>14</sup> Shih aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit të inspektimit.